



Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme

Autorë:
Samet Shabani
Amir Kadri

Shkup 2018



Kingdom of the Netherlands

Ky projekt është i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës në Maqedoni. Mendimet, zbulimet dhe konkluzionet ose rekomandimet e paraqitura këtu janë të implementuesit/autorëve dhe nuk i reflektojnë domosdoshmërisht ato të ambasadës.

Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme

Autorë:

Samet Shabani

Amir Kadri



Kingdom of the Netherlands



© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra për Hulumtime Analitika. Te drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-052 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Qendrës për Hulumtime Analitika dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht ato të partnerëve a të donatorëve të saj.

Botues

Analytica Think Tank

Autorë

Samet Shabani dhe
Amir Kadri

Kontribues

Filip Stojkovski,
ish-hulumtues në Analitika Think Tank

Redaktimi i brendshëm

Kaltrina Selimi,
hulumtues ndihmës në Analitika Think Tank

Përkthyes

Lindita Bilalli Abdullahu *(në shqip)* dhe
Ognena Nikuljski *(në maqedonisht)*

Korigjim gjuhësor

Bettina Jones Stojkovska *(në anglisht)*

Dizajnim

Muhsin Güler

Shënim

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Hyrje | 6 |
| Raport për analizë të politikave: Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme | 7 |
| Ekstremizmi i dhunshëm dhe nxitësit e tij: një pasqyrë e shkurtër | 8 |
| Konteksti i Maqedonisë | 9 |
| Faktorët dhe nxitësit | 10 |
| Shkollat e mesme nën thjerrë | 11 |
| OJQ-të: Angazhimi i komunitetit në Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm | 16 |
| Çfarë thonë predikuesit fetar për kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm | 20 |
| Çfarë thotë bashkësia akademike në Maqedoni për këtë? | 25 |
| Fokus grupet | 32 |
| Propaganda në internet | 34 |
| Sondazhi mbi Kundërvënien e Ekstremizmit të Dhunshëm | 40 |
| Rezultatet e të dhënave dhe analiza | 41 |
| Konkluzat | 51 |
| Rekomandime | 53 |
| Bibliografi | 55 |

Hyrje

Ky dokument për analizë të politikave fokusohet në faktorët specifik dhe nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni që synon të adresojë rrënjët thelbësore të kësaj çështjeje duke hulumtuar dinamikën e zhvillimit dhe manifestimit të saj me shpresë të kontribuimit drejt ndërtimit të shoqërive më të qëndrueshme. Periudha kërkimore kaloi nëpër disa faza të grumbullimit dhe procesimit të informatave cilësore dhe sasiore të rëndësishme për analizën tonë. Gjatë këtyre fazave, u realizuan intervista me zyrtarë të pushtetit lokal dhe atij qendror, të pasuara më vonë me shumë biseda formale dhe joformale me pale relevante të interesit dhe individë që janë në interes të temës së hulumtimit. Në të njëjtën mënyrë, përpjekjet për të matur mendimet dominuese midis popullsisë së përzgjedhur janë bërë duke realizuar një anketë në komunat në fjalë në Maqedoni, aty ku ata banojnë. Krahas kësaj, për pyetjet me qëllim që të kuptohet ideologjia që po qarkullon e njohur për përdorimin e saj si motiv për ekstremizëm të dhunshëm, janë konsultuar klerikë fetar. Së fundi, përmbajtja në internet e gjetur si përkrahëse e ekstremizmit të dhunshëm është analizuar deri në përdorimin e gjuhës lokale duke përcjellë një analizë të strukturuar të përmbajtjes. Këto gjetje nga hulumtimi na çojnë të fokusohemi më shumë në çështjet në vijim:

- Kërcënimi nga politizimi i personelit në shkolla dhe kanalet e pakta të komunikimit midis mësuesve, prindërve dhe nxënësve çojnë në atë që shkollat e mesme të jenë një vend i cënueshëm për grupet ekstremiste të dhunshme.
- Kapacitetet e OJQ-ve të shndërrohen në aktorë aktiv në strukturimin e qëndrueshmërisë.
- Roli i klerikëve (hoxhallarëve) në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel lokal.
- Mungesa e besimit tek institucionet publike në ndërtimin e qëndrueshmërisë së bashkësisë.
- Mungesa e narrativëve të kundërt në internet me kontekst lokal.

Raport për analizë të politikave: Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme

Ky studim kërkues ka për qëllim që të zbulojë shkaqet thelbësore të ekstremizmit të dhunshëm me fokus në qytetin e Shkupit sidomos komunat e përzgjedhura si ajo e Çairit, Gazi Babës dhe Sarajit. Qyteti i Shkupit u zgjodh për shkak të numrit të lartë të rasteve të raportuara të luftëtarëve të huaj nga kryeqyteti. Një element shtesë në përzgjedhjen e Shkupit për ne është mundësia që të bëjmë një hulumtim të hollësishëm në këto komuna në veçanti, duke marrë parasysh të dhënat e mëparshme nga hulumtimet e Analytica's mbi ekstremizmin e dhunshëm. Për shkak të numrit të rritur të luftëtarëve të huaj që janë kthyer, është e rëndësishme së madhe që të vazhdohet me vlerësimin e kryeqytetit të Maqedonisë kur bëhet fjalë për çështjen e kundërvënies së ekstremizmit të dhunshëm gjatë 2017.

Duke vazhduar me dokumentin paraprak të Analitikës “Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm, këndvështrim nga shoqëria civile”¹, ky hulumtim është vazhdim i cili kësaj radhe fokusohet në bashkësinë. Projekti hulumtues “Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme” fokusohet në faktorët dhe nxitësit e radikalizimit të gjetura apo krijuara nga rrethanat që gjenden brenda bashkësive.

Kështu, raporti për analizë të politikave do të jep një pasqyrë më të qartë mbi shkaqet kryesore, rrënjët dhe efektet e ekstremizmit të dhunshëm në kryeqytetin e Maqedonisë dhe gjithashtu do të heton perceptimin drejt tij. Është vendimtare që të kuptohen nxitësit e radikalizimit në Shkup me qëllim që të punohet më mire në luftimin e këtyre nxitësve. Për shkak të kompleksitetit të ekstremizmit të dhunshëm, ky studim do të përpigjet që të shikojë të gjithë nxitësit e mundshëm dhe të analizojë fenomenin nga shumë kënde të ndryshme.

Pjesa e parë e këtij studimi do të sigurojë një hyrje për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të rishikojë hulumtimin ekzistues mbi nxitësit e radikalizimit në shkallë globale. Pjesa e dytë e studimit do të konsiderojë ekstremizmin e dhunshëm si që ekziston në Maqedoni dhe të sigurojë disa specifika lokale. Pjesa e tretë do të sigurojë rezultate nga hulumtimi i saj nëpër fokus grupe dhe intervista mbi nxitësit e ekstremizmit në Maqedoni. Pjesa e katërt do të nxjerr disa konkluzë rreth propagandës në internet dhe si e njëjta përdoret për ekstremizëm. Pjesa e fundit do të reflektojë perceptimin e qytetarëve rreth çështjeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm.

¹* “Assessment of Macedonia’s efforts in Countering Violent Extremism, view from civil society”, Kaltrina Selimi and Filip Stojkovski, Analytica Think Tank. Online accessible at: http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf

Ekstremizmi i dhunshëm dhe nxitësit e tij: një pasqyrë e shkurtër

Pjesa e parë e këtij studimi do të prezantojë fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të jep një përmbledhje të raportit i cili është realizuar deri më tani globalisht për nxitësit e radikalizimit, duke hulumtuar se çfarë thotë literatura mbi këtë çështje. Ajo ekzaminon spektrin e gjerë të faktorëve që kontribuojnë në radikalizimin e individëve. Përmes kësaj, ne përmbledhim atë që literature e tregon mbi nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm dhe përpigëmi të identifikojmë faktorët që duken të jenë të rëndësishme gjithandej në literature. Kjo është e rëndësishme me qëllim që të hidhet poshtë miti se varfëria dhe mungesa e arsimit janë faktorët e vetëm apo kryesorë të cilët çojnë drejt radikalizimit, gjë e cila jo vetëm që nuk është e saktë por mund gjithashtu të çojë drejt përgjigjeve të papërshtatshme ndaj fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm. Është thelbësore të kuptohet kompleksiteti i shkaqeve rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm në përgjithësi, me qëllim që më mirë të hulumtohet në kuadër të kontekstit të Shkupit si kryeqytet i Maqedonisë.

Ekstremizmi i dhunshëm (EDh) si fenomen ka marrë shumë vëmendje në politikën ndërkombëtare dhe diskutet zhvillimore, dhe sigurisht, si rezultat i vetëdijësimit të rritur se ekziston nevoja për të reaguar ndaj rrënjëve të aktivitetit terrorist më shumë se sa thjeshtë të fokusohet në parandalimin e sulmeve. Kundërvënja ndaj ekstremizmit të dhunshëm apo KEDh është një çasje e gjerë e cila përpigëti që të ekzaminojë dhe adresojë shkaqet dhe faktorët të cilët çojnë drejt asaj që individët të pranojnë ideologjitë ekstremiste. Një sfidë e cila është ngritur në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm është përpjekja për të identifikuar shkaqet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat janë shpesh të shumëanshme. Me anë të kësaj, çdo pretendim për gjetjen e “kauzës” kryesore do të ishte e ekzagjeruar për shkak të mundësisë që nxitësi të shkaktohej nga një nxitës tjetër i padukshëm ose të paktën të vë në dukje një nxitës kryesor kur në fakt, shumë prej tyre janë në lojë. Hyrja në vijim mbi nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm do të përshkruajë argumentet e ndryshme mbi “nxitësit” kryesor të ekstremizmit të dhunshëm dhe kritikën thjeshtësimin tej mase i cili shpesh shqetëson projektet e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm mbi “nxitësit” dhe kuptimin e përbashkët të “shkaqeve” të ekstremizmit të dhunshëm.

Ekstremizmi i dhunshëm është në fakt një fenomen i ndërlikuar, i cili nuk është i shkaktuar nga një nxitës i vetëm por më shumë është rezultat i nxitësve të shumtë që janë ndërthurrur dhe vetë-përforcuar. Gjithashtu nuk ekziston një “rrugë e sigurtë” për tendencat ekstremiste. Ekziston një keqkuptim i zakonshëm se papunësia ose zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik çojnë drejtpërsëdrejti kah ekstremizmi si faktor kryesor, por nuk ka dëshmi të qarta për këtë. Në të shumtën e rasteve, ky nxitës është vetëm një nga shumë nxitësit e tjerë të radikalizimit. Në përgjithësi, krijuesit e politikave duhet të jenë të vetëdijshëm për natyrën problematike në fokusimin e faktorëve shtytës kontekstual të nivelit të lartë (shërbimi i dobët, papunësia etj.)

Një model i dobishëm i cili është konstruktuar për të menduar për rrjetin e ndërlikuar të faktorëve të cilët mund të çojnë kah tendencat ekstremiste në të ashtuquajturin model tre-shtresor, me faktorët rrethor dominues në nivelin makro/kombëtar/të bashkësisë, faktorët social/kulturor në nivelin mesatar grupor të identitetit dhe faktorë individual në nivelin mikro.² Përderisa provat që dëshmojnë rëndësinë e faktorëve të

^{2*} USAID, Guide to the Drivers of Violent Extremism (Udhërrefyes për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm), fq. 28, e qasur në: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf

caktuar është temë diskutimi, ekspertët pajtohen në përgjithësi se procesi i radikalizimit është proces social, dtth përfshirja e të tjerëve është qenësore. Ky vështrim i sheh të ashtuquajturit “aktorë të vetmuar” si përjashtim nga rregulli.

Në kuptimin e asaj që në këtë punim do të quhet “nxitës” kah ekstremizmi, ekzistojnë edhe nxitës, ndikimi i të cilëve zakonisht është tepruar ose bile identifikuar gabimisht. Për shembull, idetë e mashkullores dhe niveli arsimor nuk duket të kenë ndikim tek njerëzit drejt ekstremizmit. Por, në anën tjetër, arsimimi me cilësi të lartë që nga mosha e hershme e tutje, është mbrojtja më e mire kundër përjashtimit social i cili është asocuar me ekstremizmin.³ Një tjetër nxitës i cili shpesh është i mbivlerësuar është pjesëmarrja në Medrese (shkollat e mesme islamike). Përderisa ekzistojnë Medrese jo formale veçanërisht në Lindjen e mesme, sikurse në Arabinë Saudite ose Iran, të cilat luajnë rol në nxitjen e njerëzve drejt ekstremizmit, në kontekstin e Maqedonisë, mësimet burojnë nga shkolla Hanefi e mendimit dhe janë nën menaxhimin e Bashkësisë Fetare Islame, Në fakt, arsimimi fetar mund të shërbejë si mbrojtje kundër ekstremizmit.⁴

Konteksti i Maqedonisë

Kjo pjesë e raportit prezanton fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni. Këtë e bën duke shikuar se si ka ndikuar ekstremizmi i dhunshëm mbi Maqedoninë dhe cilat janë pasojat prej saj. Krahas kësaj, shikon se si ekstremizmi i dhunshëm ia ka arritur të përhapet në Maqedoni dhe në veçanti në komunat e analizuar. Përfundimisht, përcakton nëse janë bërë çfarëdo përpjekje për të hulumtuar faktorët nxitës të radikalizimit në Maqedoni.

Pas rënies së Jugosllavisë dhe konflikteve dhe luftërave civile që pasuan, grupet radikale të rrënjosura në Lindjen e mesme u fokusuan në synimin e shteteve sapo të pavarura. Në Maqedoni, një shtet me një mjedis shoqëror shumëetnik dhe popullsi prej dy million banorëve, ku grupet ekstremiste kanë qenë të suksesshëm në gjetjen e një “toke pjellore” në periudhën pas konfliktit të armatosur të vitit 2001. Kjo tokë, deri në atë kohë, ka qenë e strukturuar në lagje të caktuara të shtetit të cilat rezultuan me një përkrahje solide të rekrutimit tek grupet terroriste që luftonin në Siri dhe Irak⁵.

Sipas dokumentit për analizë të politikave të botuar nga Soufan Group, ekzistojnë gjithsej 915 luftëtarë të huaj nga Ballkani të cilët u janë bashkëngjitur grupeve ekstremiste (deri në v. 2016)⁶. Mosha e atyre që bashkëngjiten është nga 18 deri në 43 vjet. Sa i përket Maqedonisë, deklaratat zyrtare tregojnë se ka pasur 110 luftëtarë nga vendi në fushebejtat e Sirisë dhe Irakut. Për më tepër, 25 janë vrarë në Siri ndërsa 86 luftëtarë veç më janë kthyer në Maqedoni. Sidoqoftë, qasja e shtetit ngel repressive, kryesisht e fokusuar në masat ligjore dhe repressive, siç janë ndryshimet në ligjin penal dhe arrestimet policore.

³* Komisioni Evropian, “Supporting the Prevention of Radicalization Leading to Violent Extremism” (Mbështetja e parandalimit të radikalizimit i cili çon drejt ekstremizmit të dhunshëm) fq. 9, e qasur në: http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/repository/education/library/publications/2016/communication-preventing-radicalisation_en.pdf

⁴* USAID, Guide to the Drivers of Violent Extremism ((Udhërrefyes për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm)

⁵* “Ruajtja e shkollave nga ekstremizmi i dhunshëm: një qasje e gjerë drejt kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm me theks në kapacitetet edukative”, Samet Shabani, Analytica Think Tank. Gjetet në: http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf

⁶* Richard Barrett, Luftëtarët e huaj në Siri, Soufan Group, June 2014, e qasur në: <http://soufangroup.com/wp-content/uploads/2014/06/TSG-Foreign-Fighters-in-Syria.pdf>

Për më tepër, përpjekjet e shtetit për të trajtuar këtë fenomen kanë ngelur mbrenda suazave të Strategjisë kombëtare për luftë kundër terrorizmit, për shumë vite me radhë. Sidoqoftë, kohëve të fundit, qeveria e Maqedonisë ka themeluar Komitetin nacional për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit, e cila për momentin po punon në një strategji specifike mbi parandalimin/kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm. Duke pasur këtë parasysh, është vitale që të kihet një hulumtim dhe analizë e thuktë në nivelin bazë i cili do të korrespondojë me planet për veprim.

Faktorët dhe nxitësit

Objektiva kryesore e kësaj pjese të studimit është të merren njohuri mbi faktorët e ndryshëm dhe nxitësit të cilët shtyejnë njerëzit kah ekstremizmi i dhunshëm në tre komuna të përzgjedhura në Qytetin e Shkupit (Çair, Saraj dhe Gazi Babë). Kjo është informatë e rëndësishme për autoritetet në Maqedoni me qëllim që ata të bëjnë përgjigje të përshtatshme për faktorët shtytës drejt ekstremizmit të dhunshëm. Për të zbuluar faktorët dhe nxitësit e vërtetë është një detyrë e ndërlikuar dhe kërkon një qasje gjithpërfshirëse e cila shikon temën nga këndvështrime të ndryshme. Duke marrë parasysh këtë, kjo pjesë e studimit përfshin intervista me palë të ndryshme të interesit (predikues fetarë, përfaqësues të OJQ-ve, profesorë në shkolla të mesme dhe universitete) dhe grupe fokusi me të rinj nga komunat e synuara me këtë studim, të moshës prej 18 deri në 25 vjeçare.

Përmes këtyre veglave, kjo pjesë synon të na ndihmojë që të kuptojmë faktorët e shtytjes dhe tërheqjes për radikalizimin nga këndvështrimi i personave të ndikuar në mënyra të ndryshme nga ky fenomen. Kjo pjesë e studimit gjithashtu ka për qëllim që të testojë hipoteza të caktuara mbi nxitësit e mundshëm të radikalizimit siç janë: faktorët socioekonomik, faktorët ideologjik, faktorët personal dhe më shumë.

Pyetjet të cilat i shqyrtojmë në këtë pjesë janë:

- Cilët janë faktorët shtytës për radikalizim në qytetin e Shkupit (Komunat e Çairit, Sarajit dhe Gazi Babës)?
- Cili është perceptioni të cilin e kanë njerëzit kur bëhet fjalë për këta faktorë?
- Sa mendojnë individët se radikalizimi i ndikon qarqet e tyre sociale?

Shkollat e mesme nën thjerrë

Kjo pjesë e raportit për analizë të politikave përfshin hulumtimin e bërë në bazë të intervistave me profesorët e shkollave të mesme. Gjithsej, njëmbëdhjetë mësime nga shkolla të mesme të ndryshme (mbrenda komunave të synuara me këtë studim dhe më gjerë) janë intervistuar me qëllim që të japin një vërtetim të përgjithshëm në lidhje me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm midis nxënësve. Pothuajse të gjithë profesorët ishin të hapur për të diskutuar dhe ndarë brengat e tyre në lidhje me këtë fenomen. U vërejt se ata janë të vetëdijshëm për këtë çështje por ju mungon mënyra se si ta adresojnë atë kur vie tek parandalimi apo intervenimi në raste specifike.

“Në orën time të kujdestarisë, pëpiqem të flas me ta për efektet negative të ekstremizmit të dhunshëm, por edhe ne si profesorë nuk kemi mjaft informata edukative në lidhje me këtë temë, andaj do të kishte qenë mirë që të organizohen mësimet në klasa, në të cilat nxënësit do të ishin më të informuar dhe do t’u jepeshin këshilla.”
Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga “Marija Kiri Sklodovska”

Kryesisht, të gjithë profesorët u shprehën se studentët nuk janë të informuar mjaftueshëm për vlerat siç janë shumëkulturalizmi, solidariteti dhe respekti i mendimit të tjetrit. Bile edhe në shkolla të përziera etnikisht, në të cilat ka lëndë mësimore në tre gjuhë të ndryshme, shumica e nxënësve nuk bashkëveprojnë me nxënësit nga përkatësitë e ndryshme etnike. Për më tepër, gjatë disa aktiviteteve të përbashkëta midis shkollave të mesme në gjuhën maqedonase dhe shqipe mbi ngritjen e vetëdijes për shumëkulturalizmit, është vërejtur se nxënësit ndjehen çuditshëm për pjesëmarrje në këto projekte. Në këtë mënyrë, prezenca e stereotipeve për njëri tjetrin çon drejt një fenomeni në rritje të segregimit dhe një terren të brishtë për ide ekstremiste që në moshë të hershme.⁷ Krahas kësaj, programi mësimor në të shumtën e shkollave nuk përkon me narrativën në të cilën jetojnë të rinjtë sot në Maqedoni, veçanërisht nëse janë nga përkatësi të ndryshme etnike dhe nuk janë me origjinë etnike maqedonase⁸. Shumica e profesorëve besojnë se politika arsimore e vendit nuk ka strategji për atë se si të trajtojnë këta të rinj dhe frustrimet dhe frigmat e tyre. Sipas tyre, kjo situatë funksionon në favor të grupeve ekstremiste dhe përpjekjet e tyre që të ndërtojnë stereotipe tek të rinjtë kundër shtetit ku kanë lindur dhe shumicës së popullsisë në Maqedoni. Kështu, analiza tregon se njëri nga faktorët kryesor shtytës drejt ekstremizmit të dhunshëm, në veçanti në shtete shumë-etnike, është mungesa e promovimit të dialogut ndërkulturor në shkollat e mesme.

Të pyetur nëse janë mjaft të informuar nxënësit dhe studentët rreth ekstremizmit të dhunshëm, vështrimi i përgjithshëm është se ata kanë njohuri themelore vetëm nga ajo që shikojnë në TV dhe nëpër mediat sociale. Shpesh ka diskutime midis nxënësve për grupet ekstremiste, në lidhje me rekrutim të ndonjë shokut, luftëtarë i mëparshëm i huaj apo sulm terrorist i shfaqur në media, por jo edhe në formë të debatit të moderuar nga profesorët. Është një zbulim i jashtëzakonshëm se profesorët shpesh përcjellin studentët e tyre nëpër mediat sociale dhe komunikojnë në privat me disa nga ata që postojnë ide ekstremiste.

^{7*} Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga Shkolla e mesme për ekonomi dhe drejtësi ‘Arseni Jovkov’, e realizuar më 16.03.2017

^{8*} Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga Gjimnazi ‘Cvetan Dimov’, e realizuar më 01.03.2017

Profesorët gjithashtu kanë deklaruar se pothuajse nuk ekziston kurrfarë diskutimi tek personeli në lidhje me këtë fenomen. Ata ndonjëherë përmendin disa raste të nxënësve/studentëve tek të cilët vërejnë ndryshime në lidhje me ndonjë shprehje të prirjes për sjellje radikale, por kjo ngel si një bisedë e përditshme joformale me njëri tjetrin. Kryesisht, vërejtja jonë është se kjo temë perceptohet si çështje jo serioze për shkak të numrit të vogël të rasteve që kanë ngjarë në të kaluarën. Sidoqoftë, kishte vetëm një rast të raportuar në vitin akademik 2014/15 (deri tek Ministria e punëve të mbrendshme nga një mësimdhënës) për atë se një mësimdhënës ka shpërndarë fletushka dhe libra me përmbajtje ekstremiste tek nxënësit⁹. Ka pasur edhe disa raste ku bordi shkollor ka paralajmëruar disa kolegë nga personeli si pasojë e ankesave nga disa prindër se ata kanë folur për fenë gjatë lëndës së tyre mësimore. Sidoqoftë, nuk janë marrë kurrfarë masash konkrete ndaj atyre mësimdhënësve për shkak se punësimi i tyre ka qenë në bazë të përkatësive të tyre politike me pushtetin lokal¹⁰.

Ka pasur shtatë raste të raportuara në të cilat nxënësit kanë përfunduar ose në fushëbetejat e Sirisë dhe Irakut duke iu bashkëngjitur grupeve ekstremiste ose duke i përkrahur ata gjatë jetës shkollore dhe më pas. Rastet janë si vijojnë:

1. *“Në të kaluarën, kisha një nxënës I cili ishte I manipuluar në kontekstin e fees dhe përfundoi në grupet ekstreme. Ai kishte situata që tregonin dhunë dhe aggression në bashkësinë tone dhe në bashkësitë e tjera gjithashtu. Nuk e di saktësisht se çfarë ndodhi me të, por si dëgjova ai tani ka shkuar në vendet ku ka luftë, por e them këtë me rezervimet më të mëdha sepse kjo është vetëm me të dëgjuar, me kanë thënë se është dënuar nga shteti para se të shkojë. Suksesi i tij në shkollë ishte mesatar në fazat e hershme, por pas kësaj ai filloi të manipulohet nga grupe të ndryshme. Isha në kontakt të drejtpërdrejtë me familjen e tij në mënyrë personale dhe me shkollën si institucion gjithashtu. Raporti i tij me nxënësit e tjerë ishte i mirë në fillim. Pas një kohe, filloi të imponojë idetë e tija fetare, ndjehej si lider, me mendjemadhësi. Ai e bënte këtë gjithmonë në emër të fesë, por ishte i keqpërdorur nga grupe më të larta dhe persona të cilët unë nuk i njoh, por pastaj familja e atij e vërtetuan këtë, se djali im po takohet shumë shpesh me një imam të panjohur, nuk mund ta kontrolloj fëmijun tim. U përpoqa t’ia zgjas dorën dhe ta nxjerr nga situata, por përfunduam keq me personin dhe nuk kontaktova më asnjëherë me të, por familja e tij ka respekt të madh për përpjekjen time dhe kontributin që e dhash për të. Ndoshta fatin e kishte të tillë. Ai ishte shumë i mirë me personelin e shkollës në fillim deri në një periudhë të caktuar, pastaj kaloi në agresion, në fakt ai vazhdoi të dominohet nga një tjetër shpirt. (intervistë me profesor të shkollës së mesme nga gjimnazi “Gjorgi Dimitrov”)*
2. *Prej 300 nxënësve unë kam parë 2 raste në Facebook ku nxënësit kanë postuar gjëra të pahijshme në lidhje me ndodhitë e fundit në Siri, dhe unë u jam afruar dhe i kam këshilluar, ka pasur raste kur kanë lënë mësimin për t’u falur dhe unë i kam pyetur se përse e bëjnë këtë dhe unë i këshilloj se janë kundërshtues sepse kanë dale jashtë orës, nga dituria që është e patjetërsueshme në fe, ata kanë notën 1 në ditat por nga ana tjetër përpiqen të tregojnë se janë musliman të mirë. Kjo është kuptimi i keq i fesë tek nxënësit.*
3. *Ishte një nxënës i cili u rekrutua pas mbarimit të shkollës së mesme, ishte shumë nxënës i mirë, ishim të shokuar kur dëgjuam se ishte rekrutuar për të shkuar në*

^{9*} Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga Shkolla e mesme e mjekësisë ‘Marija Kiri Sklodovska’, realizuar më 01.03.2017

^{10*} Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga Shkolla e mesme ‘Zef Lush Marku’, realizuar më 10.03.2017

Siri dhe aty përfundoi tragjikisht. (intervistë me profesor të shkollës së mesme nga gjimnazi “Cvetan Dimov”)

4. “Unë personalisht kisha përvojën duke kontaktuar një prind të një nxënësi i cili filloi të prish suksesin, por jo sepse nuk dëshironte të mësonte por filloi ti klasifikonte materialet, duke thënë “kjo temë është haram (e ndaluar) për ta mësuar”, dhe kështu filloi të mungojë në orë, filloi të bëjë telashe. Prindi i tij më tha që është përpjekur ta kthejë djalin nga ky grup por ka qenë pa sukses, e inkurajova babain e tij të vazhdojë me këtë dhe gjithashtu ta ndihmojë me qëllim që të distancojë djalin e tij nga këto probleme dhe më besoni ose jo, ne filluam të kemi sukses dhe i riu filloi ti kthehet normales, dua të them se nuk ka reagim nga familjet e tyre sepse të gjitha familjet dëshirojnë që ata fëmijë të bëhen shkenctarë e jo ekstremist.” (intervistë me profesor të shkollës së mesme “Arseni Jovkov” Shkolla e ekonomisë dhe drejtësisë)
5. Kam dëgjuar për një rast konkret të një të riu të rekrutuar në Siri. Ky djalosh ka kontaktuar me familjen e tij dhe ka shprehur se është penduar shumë që ka shkuar atje dhe se dëshiron të kthehet, por ka përfunduar tragjikisht. Ai ishte aq i ri dhe nuk e di suksesin e tij, por ishte i manipuluar nga organizatat ekstremiste, me keqkuptimin se po merret me çështje fetare. (intervistë me profesor të shkollës së mesme nga “Vlado Taseski”)
6. Kisha një nxënës i cili ishte në vitin e dytë të shkollës, nxënës i rregullt në plotë-kuptim të fjalës, ishte modern, i dhënë pas shkolle, gjithmonë dëshironte të dukej bukur, ishte i shoqëruar nga nxënës të tjerë, bënte sport, por me një të kaluar që asnjëherë se kisha kuptuar, ishte i rregullt në dy vitet e para, pastaj u transferua që të përcillte dy vitet e tjera si i çrregullt (vetëm në provime) me arsyetimin se ishte shumë i zënë dhe se kishte biznes familjar dhe se duhej të ndihmonte familjen e tij me biznesin, por ishte i rregullt në provimet pastaj. Vetëm sapo i kaloi provimet dhe përfundoi shkollën e mesme, mësuam se kishte shkuar në Siri dhe pas një kohe mësuam se kishte vdekur atje. Andaj them se është aq e vështirë që të vështrohet rinia që mbështet ide ekstremiste, ndonëse nuk kisha mundësinë ta takoja shpesh në dy vitet e fundit, më kujtohet si një nxënës i mirë. (Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga Arseni Jovkov)
7. Tre vite më pare kishim një nxënës në vitin e tretë të mësimit. Ishte prill kur përnjëherësh u zhduk nga shkolla. Pastaj erdhi pas shtatë muajsh (në nëntor), respektivisht në vitin e ardhshëm shkollor. Vërejtja se ishte shumë më arrogant me sjelljen e tij ndaj profesorëve dhe nxënësve gjithashtu. I pyeta kolegët nëse kishin vërejtur të njëjtën gjë tek ai, ndërsa njëri nga kolegët më tha se sipas asaj që ka dëgjuar, ai nxënës ka qenë në fushëbetajat e Sirisë dhe Irakut dhe është kthyer pas katër muajsh. Përndryshe, kur isha nxënës vetë në Shkollën e mesme ekonomike dhe të drejtësisë Arseni Jovkov, disa nxënës të klasës që ishin të përyer me ato grupe ekstremiste na ftonin në predikimet e tyre fetare dhe aktivitetet të jashtme pas mësimeve. Morra pjesë njëherë, por kur e kuptova se ishin grupi ekstremist i ISIS-it, fillova të distancohem nga ata shokë klase.” (intervistë me profesor të shkollës së mesme nga gjimnazi “Zef Lush Marku”)

Këto raste tregojnë qartë se nuk ekziston një profil i caktuar i nxënësve i cili mund të lidhet me një grup të dhunshëm ekstremist. Sidoqoftë, mësuesit theksojnë se mungesa e komunikimit me prindërit e tyre dhe ata me kushte të rënda ekonomike janë profile i përgjithshëm i atyre nxënësve. Sipas kësaj, njëra nga konkluzat e konsiderueshme të këtij hulumtimi është se të gjithë profesorët, pa përjashtim, deklaruan se faktori kryesor shtytës i rinisë drejt grupeve të dhunshme ekstremiste është mungesa e kujdesit nga prindërit e tyre. Të gjithë ata u ankuan se shumica dërmuese e prindërve asnjëherë nuk vijnë në mbledhjet prindore në shkolla, ose asnjëherë nuk kontaktojnë profesorët në asnjë formë. Një tjetër faktor i cili ishte i theksuar nga shumë profesorë ishte mungesa e aktiviteteve plotësuese shkollore mbrenda shkollës. Fakti se grupet e dhunshme ekstremiste përdorin aktivitete jashtë pas orarit mësimor për të rekrutuar të rinjë tregon se kjo është një faktor i konsiderueshëm tërheqës.

“Nga 30 nxënës, gjatë një viti, një profesor ka njohur 5 prindër në maksimum. Kujdesi i prindërve është shumë i vogël për fëmijët e tyre, dhe defekti është këtui: nëse njëri nga treshi pedagogjik (shkolla-nxënësi-prindi) nuk është prezent, nxënësit mund shumë lehtë të devijojnë sepse ka shumë alternativa për këtë në ditë të sodit, prindërit nuk janë të informuar se ku po ju shkojnë fëmijët pas orëve të mësimi.”

Intervistë me një profesor të shkollës së mesme "Arseni Jovkov"

“Metoda të tjera të manipulimit janë kushtet ekonomike, persona ndaj të cilëve nuk kujdesen mirë familjet e tyre, grupet ekstreme së pari vështrojnë pikat e dobëta dhe i ndjekin në bazë të situatave që kanë personat.”

Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga gjimnazi "Gjorgi Dimitrov"

“Mendoj se kushtet ekonomike janë brenga kryesore me të cilën i mashtrojnë dhe rekrutojnë rininë, ata i mashtrojnë duke ju premtuar shtëpi për banim dhe se do të kenë kushte të shkëlqyeshme për jetë dhe një tjetër çështje është se ata i bindin se kjo është “sevap” (vepër e mirë) për të shkuar dhe për të shpëtuar njerëz të pafajshëm atje dhe të luftojnë kundër krimeve dhe padrejtësisë nëpër ato vende.”

Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga “Marija Kiri Sklodovska”

“Nxënësit që kanë simpati ndaj grupeve ekstreme vijnë nga “familje të lodhura” të cilat nuk kanë raporte të mira me prindërit.”

Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga "Cvetan Dimov"

“Ekstremistët shpesh ndjekin pikat e dobëta të instinktit apo ata me kushte të këqija ekonomike, ata ofrojnë ndihmë financiare në mënyrë të “sinqertë”, por pasojat janë e kundërta. Dikush ka problem se nuk kujdeset për veten e tyre dhe mendjen e tyre. Profeti Muhammed ka thënë se xihadi i parë është të kujdesesh për familjen tënde, nëse ju ndihmon atyre, i ndihmon shoqërisë, por të tjerë kanë problem në mendjen e tyre dhe infiltrohen dhe japin informata të rrejshme, pasi që në këtu jemi shumë të mirë kështu që duhet të shpëtojmë vëllezërit tanë. Vëllezërit e tanë të parë janë fqinjët, familjarët, dikush nga Shkupi, nga Saraji e tjerë, kështu që mendoj kemi shumë më shumë problem familjare dhe sociale se sa që kemi me shtetet tjera. Metoda tjetër e keqpërdorimit është se ata thonë njerëz “do të shkojmë në paraajsë nëse luftojmë padrejtësitë këtu.”

Intervistë me një profesor të shkollës së mesme nga "Saraji"

“Një metodë tjetër e manipulimit nga organizatat ekstremiste është synimi i rinisë të cilët kanë nivel të ultë të vetëdijes sociale, arsimore, fetare dhe patriotike, e pasi që ti kapin në këtë mënyrë ata fillojnë të bëjnë ndarje në mënyrë fetare dhe kjo me të vërtetë funksionon.”

Intervistë me profesor të shkollës së mesme nga "Vlado Taseski"

“Për mendimin tim, ata gjejnë personat më naiv të cilët nuk mund të mendojnë për pasojat e një çështjeje, ata gjejnë persona që kanë problem me familjen, arsimimin apo shoqërinë, zakonisht ata që përpiqen ti manipulojnë janë meshkuj, ndoshta problemet me raportet e tyre janë gjithashtu faktorë, kur një qëllim shumë i rëndësishëm jetësor nuk mund të realizohet ata ndjehen të padobishëm ndaj jetës dhe pastaj mendojnë se metodat tjera mund të zgjidhin problemin, ndoshta ideja se “unë” mund t’i ndihmoj dikujt, ose se ata dëshirojnë të “garantojnë” paraajsën dhe sa më pak njohuri që kanë për fenë, ata fillojnë të marrin njohuri të gabuara përmes këtyre grupeve.”

Intervistë me profesor të shkollës së mesme "Pançe Karagjov"

Të pyetur për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, profesorët dhanë përgjigje të ndryshme. Sidoqoftë, pesë nga ata propozuan mësim mbi fetë apo/dhe etikën në kuadër të shkollave të mesme, të cilët do të sigurojnë nxënësit me njohuritë themelore rreth të gjitha religjioneve. Përderisa disa nga ata gjithashtu propozuan reforma të thella në sistemin arsimor me qëllim që të korrespondojnë me nevojat e realitetit të sotëm në Maqedoni, një tjetër profesor thotë se mënyra më funksionale të ngritet vetëdika mvi këtë fenomen është bashkëpunimi me OShC-të për organizim të aktiviteteve të përbashkëta mbrenda dhe jashtë shkollës¹¹.

^{11*} (*) – Përshkrimi i shkurtër i organizatave është siguruar nga përgjigjet në pyetjen e parë të intervistës: Ju lutemi të na jepni informata rreth organizatës suaj (histori të shkurtër, aktivitete, misioni)
Intervistë me Bajram Kadriu, e realizuar më 24.04.2017

“Mënyra më efektive e përdorur nga grupet ekstremiste janë videot e ndryshme të cilat përdoren për të shpëlarë trurin përmes predikimeve, disa nga ata e bëjnë për ekzistencë, ndoshta ofrojnë para, ndoshta është vetëm spekulim. Mendoj se shteti është fajtori kryesor, ata duhet të parandalojnë këtë fenomen. Ne si shkollë mundohemi ta zbulojmë këtë fenomen dhe ti informojmë ata, por ata duhet të zbulojnë aktorët kryesor dhe të parandalojnë këta persona që të manipulojnë rininë.”

Intervistë me profesor të shkollës së mesme "Zef Lush Marku"

OJQ-të: Angazhimi i komunitetit në Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm

OJQ-të janë kritike për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm pasi që janë aktorë dhe organizata-bazë në kuptim të marrëdhënieve dhe angazhimit në bashkësi, me qëllim që të sigurohen këshilla dhe mbështetje për zhvillimin e nismave të përshtatshme të kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Duke e pasur parasysh këtë, ky hulumtim gjithashtu është bazuar në nivelin e organizatave-bazë për OJQ-të të cilat janë aktive në tre komunat e synuara. Intervistat janë mbajtur me pesë OJQ të cilat konsiderohen se janë aktive në fushën e rinisë, arsimit, kulturës dhe aktiviteteve humanitare. Nga pesë OJQ, katër prej tyre i kanë ndarë aktivitetet e tyre me ne siç janë të radhitura më poshtë:

Forumi Rinor Islam (FRI) është njëra prej tre OJQ-ve më të vjetra aktive në të tre komunat. Është themeluar në vitin 2000 me qëllim që të ngritë vetëdijen në mesin e të rinjve për angazhimin qytetar, parimet Islame dhe vlerat universale të njeriut. Grupi qëllimor i tyre janë të rinjtë të cilët vijojnë shkollat e mesme dhe universitetet. Aktivitetet e kësaj organizate përfshijnë seminare, trajnime, konferenca, dhe ligjërata të cilat promovojnë vlera Islame.

LEGIS është një OJQ e cila gjendet në komunën e Çairit. Është themeluar në vitin 2009 si një nismë e pesë personave. Qëllimi i tyre është arsimiti i përqendruar tek të rinjtë, posaçërisht në komuna me banorë dominues shqiptarë. Fokusi i tyre kryesor gjatë viteve të kaluara përfshinë aktivitete humanitare, hulumtime në bazë, dhe fushata të vetëdijesimit për refugjatë, respektivisht për krizën e refugjatëve sirianë, gjë që ishte agjendë e popullarizuar në Maqedoni si një vend tranzitor për valën e migrantëve. Ata gjithashtu ishin shumë aktiv në avokimin e ndryshimeve të statusit ligjor të migrantëve në vend. Partnerë të tyre kryesisht janë nga Europa, ku përmes granteve dhe thirrjeve të ndryshme, organizojnë aktivitete të përbashkëta humanitare për refugjatët dhe për banorët e vendit.

RACIO është edhe një OJQ e cila gjendet në komunën e Çairit, e cila është themeluar në vitin 2009. Qëllimi i tyre është të rrisë ndërgjegjësimin e të rinjve për angazhim qytetar. Sfera e tyre kryesore është zhvillimi personal, arsimit dhe kultura. Ata organizojnë aktivitete siç është trajnimi në komunikim, menaxhimi i konflikteve, gara në shkrimin e eseve, etj. Ata kryesisht financohen në baza vullnetare nga anëtarët aktiv në sektorin e biznesit. Ata janë bërë të njohur posaçërisht në mesin e të rinjve në të tre komunat, posaçërisht nga nxënësit e shkollave të mesme.

Fondacioni Albiz është themeluar në 2011 dhe gjendet në komunën Saraj. Është organizatë jo fitimprurëse dhe e financuar nga sipërmarrja e mirënjohur lokale Dauti Komerc. Qëllimi i fondacionit është që të promovojë përgjegjësi në një shoqëri bashkëpunuese dhe filantropi përmes organizimit të aktiviteteve arsimore, socio-ekonomike dhe kulturore ku grupi qëllimor i tyre janë rinia. Fondacioni ka definuar tre qëllime strategjike: platformë edukative, platformë kulturore dhe platformë socio-humanitare. Për të arritur këto qëllime, ata vepron me aktivitete siç janë bursat për nxënës dhe studentë, trajnime për zhvillim personal të rinisë, fushata për vetëdijësim kulturor, dhe aktivitete bamirëse për nevojtarët.

Kur bëhet fjalë për perceptimin e tyre se sa është e informuar bashkësia për ekstremizmin e dhunshëm, kishte qasje të ndryshme. FRI beson se rinia në Maqedoni po përballet me shumë probleme tjera, dhe prandaj, nuk kanë shumë hapësirë që ata të informohen ose madje të angazhohen me grupet e dhunshme ekstremiste. Sipas tyre, edhe pse ekziston një numër i madh të cilët informohen nga ajo që e shohin në internet dhe në mediat sociale, shumica e tyre kanë qasje negative ndaj grupeve të dhunshme ekstremiste, ose nuk i mbështesin ato¹². Përfaqësuesi i fondacionit Albiz theksoi se ekstremizmi i dhunshëm kryesisht prekë rininë e cila ka nivel të ulët të arsimimit dhe gjendje të rëndë sociale, ose një të kaluar të keqe me familjet e tyre. Duke theksuar se ka pasur disa raste ku të rinj kanë përfunduar në fushëbetet e Sirisë dhe Irakut, qasja e tyre është se fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm nuk është paraqitur në komunën e tyre pasi që janë komunë shumë rurale dhe pasi që bashkësia insiston në praktikimin e Islamit ‘tradicional’.

Të pyetur se a kanë kryer ndonjë aktivitete në këtë drejtim, LEGIS theksoi se si organizatë, ata aktivitetet dhe përqendrimin e tyre të deritanishëm, e kanë fokusuar kryesisht në krizën e migrantëve, në ngritjen e vetëdijes së popullatës si dhe në aktivitete humanitare për popullatën lokale. Megjithatë, përfaqësuesi theksoi se ata mund të konsiderojnë partneritete me projekte të nivelit të vogël ose aktivitete për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm. RACIO përmendi disa ngjarje shumë kulturore përmes së cilave ata besojnë se do të kontribuojnë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si një ndikim final. FRI ka organizuar ligjërata fetare me imamë të ndryshëm nga shtete të ndryshme, në të cilat ata në mënyrë specifike kanë folur mbi këtë fenomen. Fondacioni Albiz dhe organizata anonime theksuan se nuk kanë qenë të angazhuar në aktivitete të kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Megjithatë, konsiderohet që ekstremizmi i dhunshëm duhet të përballet në një mënyrë shumë specifike, duke konsideruar aspektet sociale dhe politike, si dhe ato ndërkombëtare pasi që “rinia dëshiron një botë pa padrejtësi dhe pa diktatura”. Në një dekla-

^{12*} Intervistë me Fisnik Fisnik Shabani, Kryesues i Forumit Rinor Islam, e realizuar më 02.03.2017

ratë tjetër, në pyetjen se cila është qasja e tyre ndaj ekstremizmit të dhunshëm si organizatë, u tha se ekstremizmi i dhunshëm duhet të trajtohet me shumë kujdes dhe jo vetëm duke treguar me gisht ndaj myslimanëve. Më tepër, kur kryhet hulumtim mbi këtë temë, duhet të bëhet me shumë kujdes dhe nuk duhet të merret si diçka që është e pranueshme në mesin e tyre¹³.

Të gjitha OJQ-të pohuan se asnjëherë nuk kanë pasur kontradikta me organizata tjera të cilat nuk pajtohen me qasjen e tyre ndaj këtij fenomeni. Prandaj, të gjithë u shprehën se asnjëherë nuk u janë drejtuar të rinj me qëllim që të kërkojnë sqarim rreth disa rekrutimeve në lagjen e tyre, etj. Sa për LEGIS, problemi i përgjithshëm i shoqërisë në Maqedoni është se ata nuk i perceptojnë OJQ-të si “trupa konsultues” për çështjet e tyre sociale, dhe nuk ka ndërgjegjësim se çfarë është një OJQ me qëllim që ta konsiderojnë. Megjithatë, FRI pohon se në përgjithësi ka biseda në mesin e anëtarëve mbi këtë çështje, kryesisht duke bazohen në komente rreth asaj se çfarë kanë parë në TV¹⁴.

Duke pasur parasysh angazhimin e tyre aktiv me rininë, të gjitha OJQ-të e konsiderojnë se problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen në sferën e sektorit civil për pjesëmarrje aktive në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, është mungesa e bashkëpunimit me aktorët publik, veçanërisht në lagjet e synuara me këtë studim. Më tutje, u deklarua se problemi i përgjithshëm në Maqedoni është se OJQ-të nuk mbështeten nga aktorë relevant shtetëror për shkak të përkatësive dhe rezervimeve politike¹⁵.

Komentet mbi faktorët kryesorë se pse të rinjtë pranojnë idetë radikale janë të ndryshme. Sipas LEGIS dhe FRI, bindjet e gabuara ideologjike janë faktori kryesor për radikalizëm dhe si pasojë pason rekrutimi. Në anën tjetër, përfaqësuesi i Fondacionit Albiz u shpreh se faktori kryesor është miqësia, OJQ të tjera ishin të përqendruara në faktorët shtytës siç janë papunësia, kushtet e vështira ekonomike, niveli i ulët arsimor dhe mungesa e mundësive¹⁶.

“Siç e di nga rrethanat e mia (miqtë, të afërmit, etj.), ekzistojnë disa raste, siç më kanë thënë, për persona të cilët marrë një hap të tillë.. Të gjithë kanë shkuar në Siri pasi që kanë besuar se është puna e drejtë për ta bërë në emër të Zotit. Ekziston një perceptim se këta njerëz shkojnë atje për para, por nuk është e vërtetë, por konsideroj se mbështetja financiare nuk ka qeë arsyeja primare, paraja për ata të cilët shkojnë konsiderohet vetëm si “vlerë e shtuar” në rrugëtimin për te Zoti”

Besnik Hamiti, LEGIS

Vështrimi i përgjithshëm i të gjitha OJQ-ve është se shtytësi kryesor për qasjen ndaj të rinjve është kontakti i drejtpërdrejtë më shumë se sa “rekrutimi në internet”. Në anën tjetër, asnjë organizatë nuk siguroi përshkrim të hollësishëm se a ka dallime në rajonet (Shkup, Tetovë dhe Kumanovë) në aspekt të këtij fenomeni.

^{13*} Intervistë me OJQ, e kryer më 05.04.2017

^{14*} Intervistë me Fisnik Fisnik Shabani, Kryesues i Forumit Rinor Islam, e kryer më 02.03.2017

^{15*} Intervistë me Besnik Hamiti, bashkëthemelues i LEGIS, e kryer më 22.03.2017

^{16*} Intervistë me Fahmi Osmani, kryetar i Racio, e kryer më 03.03.2017

“Të rinjtë mund të manipulohen me lehtësi duke pranuar idetë e tyre pasi që mendoj se pala tjetër do të demanton këto ide, prindërit janë të “zënë” me punë, shkolat kanë pak efekt, ashtu që ata e përdorin këtë boshllëk në mënyrë profesionale.”

Besnik Hamiti, LEGIS

“Efekti i mediave dhe i rrjeteve sociale ka çorientuar një masë të shoqërisë, por sipas meje është e çuditshme se si një person për një vit mund të ndërrojë mendimin e tij dhe të shkojë deri në fund të asaj që është e padëshiruar”

Fisnik Shabani, Forumi Rinor Islam

Kur bëhet fjalë për mënyrat e parandalimit të rinisë nga ekstremizmi i dhunshëm, gasja e përbashkët ishte të sigurohet perspektiva në vendin tonë, duke siguruar arsim kualitativ, dhe mundësi për karrierë. Megjithatë, gjithashtu është cekur se nuk ka nevojë për mekanizma parandaluesë pasi që kjo temë nuk duhet të ekzagjerohet sepse ka shumë çështje me prioritet të cilat duhet zgjedhur siç janë, korrupsioni, varfëria, papunësia dhe politizimi i institucioneve¹⁷.

“Mënyra e vetme për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm është të sigurohen alternativa, ashtu që procedurat e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm nuk duhet të vazhdojnë duke prodhuar masa të drejtpërdrejta për të luftuar këto grupe, por duke gjetur mekanizma të ndryshëm, përmes angazhimit të të rinjve, dhe në këtë mënyrë, në mënyrë indirekte, vijnë rezultatet. Atë që dua ta them është të sigurohen mundësi në karrierë për të rinjtë, përmirësim i sistemit arsimor, etj.”

Besnik Hamiti, LEGIS

“Nëse punojmë në alternativat për të angazhuar rininë më tepër në shoqëri, kjo do të ketë më shumë ndikim në kundërvënien kundër ekstremizmit të dhunshëm se sa të luftohet drejt për së drejti, pasi që ekstremizmi i dhunshëm nuk është problem me prioritet në Maqedoni dhe kjo (kundërvënia indirekte ndaj ekstremizmit të dhunshëm) do të kishte më shumë efekt në shoqëri.”

Fisnik Shabani, FRI

^{17*} Intervistë me OJQ, e kryer më 05.04.2017

Çfarë thonë predikuesit fetar për kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm

Duke marrë parasysh se grupet e dhunshme ekstremiste shpesh i referohen Islamit si burim i tyre për legjitimim të veprimeve të tyre, ishte e rëndësishme që të përfshihen Imamët si predikues fetar islamik në këtë studim, me qëllim që të sigurohet një sqarim mbi këtë çështje. Përveç kësaj, ishte e dukshme që dinamika e bashkësisë për këtë çështje të sigurohej në komunën e tyre përkatëse.

Duke qenë kështu, Bashkësia Fetare Islame u kontaktua për të dhënë një listë prej dhjetë imamëve me qëllim që të realizohen intervista me ta. Nga dhjetë emrat e siguruar, u realizuan tre intervista. Dy refuzuan të realizojnë intervistën për shkak se thanë që nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme për të folur mbi këtë çështje. Për sa u përket pesë të tjerëve, kontaktet u kërkuan tek BFI por nuk kishte përgjigje në lidhje me këtë.

Sipas prof. Dr. Fahrudin Ebibi, Dekan i fakultetit të Studimeve Islame, terrorizmi dhe çfarëdo akti që rrjedh nga dhuna, nuk kanë vend në Islam. Rrjedhimisht, ai u shpreh se ata që vetë themelojnë grupet e dhunshme ekstremiste janë të vetëdijshëm për këtë, por ata formojnë grupet terroriste për interesa të mëdha materiale. Ai tha se ideologjitë ekstremiste kanë hyrë brenda bashkësisë në Maqedoni në të 90-tat e hershme, brenda maskës së OShC. Ai tha se qëllimi i tyre kryesor ishte të pengojnë funksionimin e RFI duke kryer aktivitete të cilat është paraparë të jenë të kryera nga ky institucion. I pyetur se përse ekstremizmi i dhunshëm vazhdimisht i referohet islamit dhe nëse ai pajtohet me termin “Ekstremizëm islamik, terrorizëm islamik, apo islam radikal”, ai shprehu se ekziston tendencë e vazhdueshme e botës perëndimore për të lidhur aktet terroriste me islamit duke krijuar stereotipa, veçanërisht përmes mediave. Ebibi gjithashtu tha se në shumicën e lëndëve të programit arsimor, ata ju sigurojnë studentëve dituri për të dalluar ekzagjerimin në vepra dhe norma islamike. Por ai tha se tema e ekstremizmit të dhunshëm nuk preket në mënyrë të veçantë, për shkak se sipas mendimit të tij që është gjithashtu dhe qasja institucionale, nuk ka diskutim e as nevojë për të pasur një lëndë/program mësimor/temë në fakultetin e tyre, për shkak se kjo nuk ka kurrfarë lidhje me islamit dhe studimin e tij¹⁸.

Dr. Fatmir Zaimi gjithashtu u shpreh se imamët në Maqedoni në mënyrë produktive kanë punuar me bashkësinë në ruajtjen e qëndrueshmërisë për sa i përket ekstremizmit të dhunshëm që nga fillimi i luftës në Siri. Ai tha se në Shkup ka 100 xhami nën ombrellën e BFI-së dhe se në vazhdimësi kanë përmendur fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm përmes predikimeve fetare. Me këtë, ata kanë ngritur vetëdijen për të qenë vigjilent ndaj këtij fenomeni. Ai gjithashtu tha se është e papranueshme të vihet Maqedonia në vëmendje në “gjenerimin” e ekstremistëve të dhunshëm për shkak të incidenteve që ndodhën në dy xhami në vitet e kaluara¹⁹.

Imami Shaban Tairi nga Komuna e Sarajit gjithashtu tha se Islami nuk njeh kurrfarë lloj ekstremizmi. Ai gjithashtu tha se profeti Muhammed ka reaguar ashpër ndaj atyre që e kanë tepruar me praktikimin e riteve islame. Përkatësisht, Tairi theksoi se sipas sheriatit (Ligjit islamik), akti me dënim më të lartë është akti i terrorizmit, apo vrasja e njerëzve të pafajshëm. I pyetur për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në lagjen e caktuar, ai tha se kontakti direkt duket të jetë shumë i rrallë. Tairi përmendi se ka pasur

^{18*} Intervistë me Prof. Dr. Fahrudin Ebibi, e realizuar më 17.07.2017

^{19*} Intervistë me Dr. Fatmir Zaimi, e realizuar më 08.05.2017

raste para operacioneve Qeliza 1 dhe Qeliza 2, në të cilat disa ekstremistë janë grumbulluar nëpër kafe, ku janë përpjekur të inkurajojnë rininë për të shkuar në Siri. Sidoqoftë, këto takime publike u ndalën pas operacioneve. Duke pasur parasysh këtë, ai tha se është detyra e shërbimeve sekrete të identifikojnë ata persona që përhapin ideologji të tilla.

“Gjithmonë i them rinisë gjatë predikimeve të mija, ‘është e lehtë të vdesësh për fenë, por është më e vështirë të jetosh dhe ta përfaqësosh në mënyrë të mirë. Është obligimi ynë të mësojmë njerëzit se si të jetojnë me islam, e jo të vdesin.”

Shaban Tairi, imam në komunën e Sarajit

Bazuar në vërtetimet e tija në lidhje me disa që janë të involvuar në grupe ekstremiste nga lagja e tij, Tairi tha se pika e tyre e përbashkët ishte që ata nuk kishin pasur dituri mbi fenë para se t’u bashkëngjiten këtyre grupeve. Krahas kësaj, ai shprehu se të gjithë ata paraprakisht kishin pasur konflikte dhe probleme me familjet e tyre. Andaj, sipas Tairit, faktori i parë shtytës kah ekstremizmi i dhunshëm është rrethana psikologjike e të ndjerit jashtëzakonisht emocional në rrethana të shndërrimit në pendim dhe pakënaqësi me të kaluarën.

“Ndjenja se kanë bërë shumë vepra të këqija i bën të ndjehen se ata mund të falen nga Zoti vetëm nëse fillojnë të praktikojnë ritualet në mënyrë ekstreme dhe me këtë të kompensojnë ‘kohën e humbur’ të së kaluarës. Në këtë mënyrë ata transformohen nga njëri ekstrem në tjetrin. Kështu, kjo i bën ata që të kërkojnë një aventurë të re ‘legale’ dhe këtë e gjejnë në narrativet ekstremiste të përhapura veçanërisht nëpër mediat sociale në këto ditë.”

Shaban Tairi, imam në komunën e Sarajit

Tairi thotë se pothuajse kontakti i parë i të gjithëve me idetë radikale nga ato raste të cilat ai i njeh, janë predikimet fetare të cilat ata i kanë shikuar përmes mediave sociale. Ai përmendi se numri i pjesëmarrësve në predikimet fetare të disa imamëve të njohur ekstremist është 10 deri në 20, por në mediat sociale ata kanë një përfshirje prej afro 70,000 shikimeve për një video. Kjo është pse, Bashkësia Fetare Islame duhet të rrisë paraqitjen e saj publike përmes kapaciteteve të internetit tha ai, sepse, sipas tij, shumica e predikimeve fetare të shikuara nëpër mediat sociale nga ana e bashkësisë fqinje janë nga ato me ide radikale. Ai sqaroi se kjo është vetëm për shkak se ekzistojnë vetëm disa kanale që promovojnë “islam tradicional” dhe jo për shkak se bashkësia i mbështet ata.

I pyetur për komunikimin e tij me popullsinë lokale (se a e pyesin për këtë fenomen), ai theksoi se ata shpesh kanë pyetur për sqarime se a është e arsyetuar fetarisht t’u bashkëngjiten grupeve të dhunshme ekstremiste me qëllim të luftimit në Siri qysh në fillim të luftës, në vitin 2011. Tairi, u shpreh se ai është kërcënuar nga disa ekstremist të lagjes për shkak se ka kritikuar në mënyrë të ashpër dhe publike grupet e dhunshme ekstremiste siç janë ISIS-i dhe Al-Nusra. Ky rast më vonë është paraqitur në Mistrinë e punëve të brendshme.

Tairi gjithashtu tha se imamët ekstremist përdorin mënyra manipulative për të interpretuar Sheriatin (ligjin islamik) me qëllim që të legjitimizojnë norma të caktuara islamike të cilat janë të ndaluara. Ai tha se kjo është e lehtë për ata për ta bërë për shkak se e kanë parasysh se publiku nuk është i pajisur mirë me dituri për ato tema të caktuara të Islamit Sipas tij, manifestim tjetër i konsiderueshëm është nëpër shumë video dhe ligje-

rime nga predikues fetarë të vetëshpallur që mbështesin interpretime ekstreme, vërehet stili i ligjëratave me tituj si imamët e devijuar, hoxhallarët e shitur, duke aluduar në hoxhallarët tradicional. Përveç kësaj, Tairi përmendi se ka shumë libra të cilat janë botuar pa kurrfarë miratimi institucional dhe se nëpunësit shtetërorë duhet të ndërmarrin masa për ti parandaluar këto.²⁰

Përveç intervistave me imamët e BFI, gjithashtu u intervistuan edhe dy predikues të tjerë fetar nga Shkolla selefiste, Bekir Halimi dhe Omer Bajrami. Është e rëndësishme të shënohet se atyre të dyve nuk u është siguruar leje zyrtare nga BFI për të qenë predikues në xhami.

Omer Bajrami ka lindur në komunën e Sarajit në Shkup në 1985. Ai ka filluar hifzin (memorizimin e gjithë Kur'anit) kur ishte dhjetë vjeçar dhe e ka mbaruar për njëzet muaj. Pastaj, në 2003, ai diplomoi nga Medreseja "Alaudin" (shkollë e lartë për studime islamike) në Prishtinë. Pasi diplomimit nga Prishtina, ai mbaroi studimet e tij teologjike në Univerzitetin Amerikan në Kajro. Ai studioi atje për 6 vjet. Pasi i ka kryer studimet, është kthyer në Maqedoni dhe ka filluar të mbajë ligjërata javore në OJQ Rinia Islame – Saraj (Rini islamike) për një kohë, pastaj në disa xhami të vendit dhe të Evropës. Në ndërkohë ai shkruan libra dhe veçanërisht poema dhe ilahi (Këngë fetare islamike).

I pyetur për perceptimin e tij mbi ekstremizmin e dhunshëm, Bajrami përmendi një citat të Profetit Muhammed duke thënë "Ekstremistët janë mposhtur!" e cila është përsëritur tre herë nga vetë profeti, me qëllim që të theksohet rëndësia e ruajtjes së baraspeshës. Andaj, ai tha, çdo teprim, goftë në kuptim të bindjes apo praktikës, është e konsideruar si ekstremizëm dhe andaj, është rreptësisht e ndaluar në islam.

Në pyetjen për arsyet e përmendjes së "Islamit" kur i referohen ekstremizmit të dhunshëm dhe nëse pajtohet me termet "Ekstremist islamik/Terrorizëm islamik/islam radikal", Omer Bajrami u shpreh se sulmet drejt islamit nga jo-muslimanët fillojnë me këto lloj "emërime", përmes të cilave më vonë, sipas tij, ata përpigën të arsyetojnë atë duke thënë se ata janë kundër një grupi të caktuar, e jo kundër Islamit. Ai tha se "mund të ketë musliman ekstrem por nuk ka Islam ekstrem"²¹.

Sipas Bajramit, çështja e ekstremizmit në Maqedoni është tepruar në krahasim me realitetin, sepse vendi asnjëherë nuk ka qenë i kërcënuar nga ndonjë sulm ekstrem. Kur bëhet fjalë për rekrutimet, ai tha se kjo është çështje tjetër e cila ka të bëjë me sjelljen personale. Përkatësisht, ai u shpreh se "rruga për në Siri ishte e 'hapur' për të gjithë që në fillimin e luftës, por strategjia e shtetit ka ndryshuar më vonë".

I pyetur se cila është qasja e tyre për sa i përket rekrutimit të grupeve të dhunshme ekstremiste për Siri dhe Irak, ose se a e arsyeton ai këtë, ai tha se në vazhdimësi po përpigjet t'ua theksojë pasuesve të tij se "ne nuk mund ti zgjidhim problemet e arabëve; problemet e tyre kanë histori të gjatë dhe shumë të ndërlikuar". Ai shtoi se "ka mënyra të tjera për të ndihmuar muslimanët, por jo duke shkuar në vendet e tyre pa e ditur gjuhën dhe kulturën e tyre. Është më mirë ti shërbejmë islamit nga vendlindja."

Sipas Bajramit, nxitësi më kryesor për rekrutimin e të rinjëve tek grupet e dhunshme ekstremiste është përmbajtja në internet. Lidhur me këtë, ai shprehu se ka të rinj që nëse do të kishte mënyrë, ata do të kishin shkuar tani në Mjanmar (duke pasur parasysh se kriza me Myslimanët e Mjanmarit ishte aktuale në ditët kur u realizua intervista) pasi që kanë parë fotografi dhe video se si myslimanët po masakrohen nga forcat shtetërore.

^{20*} Intervistë me Shaban Tairi, imam në xhami në Komunën e Sarajit, e realizuar më 22.05.2017

^{21*} Intervistë me Omer Bajrami, e realizuar më 30.08.2017

Bajrami tha se imamët në Shkup kanë biseduar për kundërvënien që po vazhdon në Siri, por se nuk ka pasur asnjë imam që ka thirrur për të luftuar atje. Sipas tij, nëse ka ndonjë imam që do të ketë bërë këtë, numri i personave të rekrutuar do të kishte qenë shumë më i madh.

I pyetur se nëse ka dëgjuar ose ka pasur ndonjë rast konkret në të cilin dikush ka përfunduar në Siri nga familjarët/fqinjët e tij, Bajrami tha se ka vetëm pak raste për të cilat ka dëgjuar në të kaluarën. Përkatësisht, ai u shpreh se është e pamundur të përmendet ndonjë profil i caktuar i njerëzve të cilët u bashkëngjiten grupeve ekstremiste të dhunshme me qëllim që të luftojnë në Siri ose Irak, për shkak se siç tha ai, “ka disa që janë shumë të pasur dhe të tjerë që janë të varfër, disa me arsim të lartë e disa me nivel shumë të ultë të cilat i janë bashkëngjitur fushëbetejës”. Ai gjithashtu shtoi se ata që janë bashkëngjitur nuk kanë pasur dosje krimi paraprakisht. Bajrami ritheksoi se çështja e rekrutimit nuk është problem real në shoqëri sepse është në “dimension individual” e jo në mënyrë të strukturuar dhe organizuar.

Përfundimisht, Bajrami tha se roli kyç për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm mund të luhet nga imamët përmes mbajtjes së predikimeve fetare në xhami dhe nëpër shkolla të mesme.

Një intervistë tjetër është bërë me Bekir Halimi, që konsiderohet si pionier i lëvizjes selefiste në Maqedoni, në veçanti në lagjet e Çairit, Gazi Babës dhe Sarajit.

Bekir Halimi është i lindur në Shkup, në vitin 1971. Pas përfundimit të Medresesë (shkollë e mesme për studime islame) në Shkup, ai përfundoi studimet e tija teologjike në Universitetin e Jordanit. Pas kthimit të tij në Maqedoni, preokupimi kryesor i Halimit ka qenë përkthimi i librave fetarë nga arabishtja në gjuhën shqipe. Ai është drejtor i Shtëpisë botuese “Nun” dhe themelues i revistës mujore “AlbIslam”.

I pyetur se përse akuzohet se është i lidhur me grupet e dhunshme ekstremiste e edhe me rekrutimin për fushëbetejat e Sirisë dhe Irakut, Halimi tha se ai është njëri nga imamët e parë që ka kritikuar ekstremizmin e dhunshëm, qysh në 2003 kur Al-Kaida ka qenë organizatë e popullarizuar terroriste. Respektivisht, ai u shpreh se të gjitha këto kritika nga fillimi i 2000-tës për Al-Kaida dhe sot për ISIS-in janë në dispozicion publik në internet. Kështu që, Halimi thotë se në këtë drejtim ai gjithmonë është përpjekur të “ndihmojë opinionin” me qëllim që të parandalojë këtë fenomen në vend, dhe në mënyrë paradoksale gjithmonë ka qenë i akuzuar për mbështetje të terrorizmit, në veçanti me financim. Ai tha se nëpunësit e sigurisë mund të kenë qasje tek burimet financiare (të ardhurat, transferime parash, grante të siguruar, etj.) Të OJQ-ve dhe të përcjellin transparencën e organizatës së tij. Sidoqoftë, ai disa akuza i ndërlidhi me shqetësimin e tij politik me partinë politike shqiptare (e cila ka qenë në pushtet në dekadën e fundit) dhe gjithashtu mospajtimet me Bashkësinë Fetare Islame, që të dyja, sipas tij, janë përpjekur ta ekspozojnë si terrorist, sidomos tek prezenca e bashkësisë ndërkombëtare në vend.

Halimi thotë se ai politikisht ka mbështetur partinë shqiptare politike në të kaluarën, bile edhe duke u rekomanduar pasuesve të tij që ta votojnë, pasi që ishte “kauza kombëtare e asaj kohe”. Sidoqoftë, sipas tij, ky establishment politik më vonë “devijoi për shkak të përfshirjes në korrupsion dhe disa “harame” (gjëra të ndaluara në islam) të tjera”, që ishin shkak që ai më të mos e përkrahte këtë parti. Në këtë drejtim, Halimi vështrohet të ketë një qasje tjetër nga grupet ekstremiste të skajshme selefiste siç janë ISIS që është i njohur të ndalojë rreptësisht votimin në shtetet “jo-muslimane”.

Kështu, i pyetur se cilat janë dallimet ideologjike midis tij dhe ekstremistëve të dhunshëm, duke konsideruar se të dyja i referohen dijetarëve të njëjtë me ideologji selefiste siç është Ibn Tejmije, Ibn Kajim El-Xhevziu, Halimi thotë se është çështje e interp-

retimit dhe mënyra e komentimit të qasjeve të tyre me realitetin e sotëm.

Kur flasim për rekrutimet nga vendi në vitet e fundit, Halimi tha se në Maqedoni nuk ka organizatë apo vend të caktuar ku tubohen ekstremistët e dhunshëm. Ai tha se ka shumë pak persona të cilët kryejnë rekrutime dhe ata janë në raport të ngushtë me shërbimet sekrete. Respektivisht, Halimi tha se ai është dëshmitar se ata persona kanë udhëtuar lirshëm brenda dhe jashtë shtetit, përderisa atij i është kufizuar udhëtimi jashtë shtetit nga zyrtarët shtetëror. Ai gjithashtu tha se numri i rekrutimeve nga Maqedonia është më i ultë në krahasim me Kosovën dhe Bosnjën e Hercegovinën, për shkak të “zërit më të lartë të imamëve nga Maqedonia me qëllimin që të mos manipulohet rinia”²². Halimi gjithashtu tha se është kërcënuar kur ka kritikuar publikisht rekrutimet në grupet e dhunshme ekstremiste me qëllimin që të luftojnë në fushëbetejat e Sirisë dhe Irakut.

Bekir Halimi tha se nxitësi për rekrutim është kontakti i drejtpërdrejtë. Sipas tij, përmbajtja e internetit vetëm që e ushqen procesin e rekrutimit. Duke komentuar për situatën momentale me këtë fenomen, Halimi deklaroi se individët e arrestuar në operacionet Qeliza 1 dhe Qeliza 2 do të konsiderohen si “heronj” nga shokët e tyre, pasi që të përfundojnë dënimin. Kjo është se pse, sipas tij, zyrtarët shtetëror duhet të fillojnë menjëherë me programe rehabilitimi brenda burgjeve. Gjithashtu, Halimi u shpreh se duhet të ketë masa parandaluese në shkollat e mesme përmes aktiviteteve të ndryshme për të ngritur vetëdijen e tyre, me futjen e mësimbesimit në shkollat e mesme dhe me aktivitete të ndryshme në natyrë.

^{22*} Intervistë me Bekir Halimi, e realizuar më 28.07.2017

Çfarë thotë bashkësia akademike në Maqedoni për këtë?

Fenomeni i rekrutimeve në fushëbetejat e Sirisë dhe Irakut dhe në përgjithësi ekstremizmi i dhunshëm, gjithashtu kanë fituar të tërheqin vëmendjen e botës akademike në rajonin e Ballkanit. Duke qenë kështu, ky studim ka për qëllim që të prek edhe perceptimin e botës akademike në Maqedoni në lidhje me këtë fenomen. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e raportit fokusohet në qasjen e profesorëve universitar në Maqedoni në lidhje me këto çështje. Janë realizuar tre intervista me qëllim që të kuptohet më mirë çështje nga këndvështrimi i akademisë. Përzgjedhja e profesorëve është bazuar mbi kualifikimin e tyre akademik dhe profesional mbi identitetet, lëvizjet sociale, sociologjinë dhe angazhimin e tyre në këtë temë.

Prof. inordinar Besa Arifi u shpreh se çështja e ekstremizmit të dhunshëm nuk është një fenomen i ri i cili po ballafaqohet në vitet e fundit, në veçanti duke marrë një vëmendje publike pas operacioneve të Qelizës 1 dhe 2. Në mendimin e saj, Maqedonia është ballafaquar me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm në forma të ndryshme, duke mos u referuar përfundimisht fesë. Arifi tha se llojet e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm, siç janë ato të motivuara nga e djathta ekstreme, mund të shihen edhe në ditë të sotme, duke përmendur incidentet e dhunshme që ndodhën në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill 2017, në të cilën shumë deputetë ishin të sulmuar dhe lënduar fizikisht²³. Për më tepër, Arifi tha se shfaqja e ekstremizmit të dhunshëm nga e djathta ekstreme në Maqedoni, në veçanti me incidentin e asaj nate, ishte e motivuar nga klerikë fetarë të cilët predikonin në protesta të cilat çuan drejt incidentit të dhunshëm.

Besa Arifi vuri në dukje se ajo mund të dallonte ekstremizmin e dhunshëm në vend duke u bazuar në veprimet e tyre: ata me karakter fetar veprojnë jashtë Maqedonisë më shumë se këtu, që është e fokusuar në rekrutimin e militantëve për pjesëmarrje në ISIS ose paraprakisht edhe formacione të tjera jolegale siç ishte rasti në revolucionin e Ukrainës, dhe e dyta, që është, sipas saj më prezent në vend, për shkak se është e përkrahur nga establishmente të caktuara politike.

Arifi gjithashtu u fokusua në faktorët global të cilët nxisin ideologjitë ekstremiste, në veçanti aty ku nuk funksionon sistemi arsimor. Megjithatë, ajo gjithashtu theksoi ndikimin e jashtëm të disa vendeve nga Lindja e mesme përmes predikimeve fetare. Sipas Arifit, shkolla Hanefi e praktikimit të islamit në Ballkan, ka qenë në shënjestër për disa vite me radhë, nga qasja ideologjike Vehabiste, e mbështetur nga disa vende nga Lindja e mesme. Duke e konsideruar se kjo është një proces dekadash, Arifi theksoi 'indiferencën' ose edhe 'stimulimin' e shtetit drejt këtij fenomeni. Në këtë drejtim, Arifi theksoi se nxitësit siç janë predikimet në internet për rekrutim, librat dhe fletushkat janë ende lehtë të kapshme që nga vitet e 90'ta. Sipas saj, kjo tregon se shteti duket të ketë qenë komot me këtë situatë kështu që kjo u bazua në zgjerimin e këtij lloji të ekstremizmit në lagje të caktuara; do të ishte më e lehtë që të shënohen etnitete të caktuara si tërësi për interesa politik. Arifi theksoi rastin Monstra, ku pesë qytetarë të përkatësisë etnike maqedonase u vranë më 12 prill 2012. Pas këtij incidenti, pesë qytetarë të përkatësisë etnike shqiptare u dënuan me burg të përjetshëm. Ministrja e punëve të brendshme e atëhershme, thotë Arifi, fajësonte islamit radikal përmes një konference për shtyp dy orë pas incidentit, pa treguar dëshmi dhe me këtë, duke shkelur Parimin e prezumimit të pafajësisë. Për më

²³* Më shumë se 70 të lënduar pasi që protestuesit futen në parlamentin e Maqedonisë dhe sulmojnë politikanët dhe policinë: <http://www.telegraph.co.uk/news/2017/04/27/protesters-storm-macedonia-parliament-social-democratic-leader/>

tepër, Besa Arifi pohonte se të gjitha faktet e këtij rasti bazohen në ‘dëshmitarë sekret’, gjë e cila implikon një rast të orkestruar politikisht dhe kështu, të keqpërdoret tema e ekstremizmit të dhunshëm. Arifi gjithashtu tha se gjithmonë ekziston potencial i shfaqjes së ekstremizmit ët dhunshëm në Ballkan, për shkak se personat që kanë qenë të përfshirë në luftërat e mëparme të rajonit asnjëherë nuk kanë kaluar nëpër risocializim.

Sipas Arifit, zyrtarët shtetërorë definitivisht merren me ata luftëtarë të huaj të mëhershëm të cilët janë penduar që kanë marrë pjesë në fushëbetejat në Siri dhe Irak, për të gjetur alternativa për risocializim të këtyre personave. Arifi pohonte se arrestimet do ti bënin edhe më shumë ekstremistë se që ishin më parë. Një tjetër fokus i Arifit ishte në punën e vazhdueshme të bashkësisë në mënyrë të koordinuar, ku besimi tek shteti duhet të jetë vital pasi që është i dëmtuar në të gjitha aspektet. Prandaj shtoi ajo, se ka organizata fetare të cilat bashkësia i sheh si më të besueshme me ta se sa Bashkësia Fetare Islame si organ përfaqësimi. Kështu, sipas Arifit, BFI duhet t’u qaset si organizata bashkëpunuese të cilat do të punonin së bashku në programe të de-radikalizimit dhe re-socializimit. Mechanizmat final për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm të propozuar nga Arifi janë të mbahen orë mbi identifikimin e këtij fenomeni, të zbatuar që nga shkolla fillore. Ajo tha se duhet mësuar se ekstremizmi nuk është fe dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë²⁴.

Në anën tjetër, asistentja në universitet Lura Pollozhani thotë se fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm është një çështje shumë serioze e cila disi ‘fshihet nën qilim’ nga institucionet relevante dhe aktorët e tjerë politik. Sipas saj, ekziston një mungesë e madhe e debatit në shoqëri dhe palë të tjera të përfshira për këtë çështje. Ajo thotë se në krahasim me Kosovën, , Maqedonia ngec pas në njohjen e këtij fenomeni i cili po rrite në vazhdimësi në terren. Ngjashëm me Arifin, Pollozhani konfirmon se ekziston qasja politike nga institucionet shtetërore mbi këtë çështje, pasi që ky fenomen perceptohet si ‘çështje e bashkësisë shqiptare dhe kështu vetë bashkësia duhet të merret me këtë, se sa të pritet që institucionet të ndër marrin masa’. Në anën tjetër, Pollozhani pohon se partitë politike shqiptare nuk kanë treguar vullnet për t’iu qasur këtij fenomeni, për shkak të frigës që të mos keqkuptohen dhe të etiketohen nga bashkësia konservative si parti anti-islame e me atë të humbin vota.

Pollozhani gjithashtu theksoi se shoqëritë në Ballkan po ballafaqohen me një periudhë të krizës së identitetit. Si argument për këtë, ajo përmendi debatet e vazhdueshme në Kosovë si “feja kundrejt kombësisë”; që, sipas saj, është një moment potencial për grupet ekstreme me qëllim që të fitojnë vëmendje dhe të mbështeten. Prandaj, Pollozhani vëren se ‘veprimet e gabuara’ nga zyrtarët shtetërorë në vendet e Ballkanit e bënë që bashkësia të perceptojë kundërvënien kundër ekstremizmit të dhunshëm si ‘presion mbi njerëzit fetar’. Kështu, tha ajo kjo mund të bëjë shumë njerëz të radikalizuar vetëm se besojnë se dikush është i shtypur pa kurrfarë faji.

Pollozhani thekson se propoaganda në internet përdoret si vegël e shpeshtë për hapat e parë mbi ekstremizmin. Sipas saj, njerëzit manipulohen përmes videove emocionale për ndodhitë në Siri, duke treguar masat shtypëse të regjimeve drejt personave të pafajshëm, ndërsa kjo në mënyrë të tërthortë fillon të bind njerëzit se çdo grup që lufton kundër këtij regjimi është legjitim. Sidoqoftë, Pollozhani thot se grupet e dhunshme ekstremiste janë më aktive në terren se sa në propagandat në internet.

Pollozhani thotë se një “faktorë shtytës” tjetër drejt grupeve të dhunshme ekstremiste janë komentet e gabuara të imamëve në tema me të cilat merret shoqëria. Sipas Pollozhanit, të gjithë predikuesit fetar duhet të jeë më të vëmendshëm në atë se si i qasen

^{24*} Intervistë me Besa Arifi, Prof. inordinare pranë Fakultetit të Drejtësisë në UEJL, e realizuar më 12.05.2017

temave që janë të bëjnë me nevojat e sotme të bashkësisë dhe se si i interpretojnë çështjet e caktuara.

Sa i përket parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, Pollozhani thekson se debatet e hapura për islamin dhe hapësira për të sqaruar tema të caktuara. Krahas kësaj, ajo thekso reformimin e sistemit arsimor duke rritur mekanizmat për mendim kritik si gjë vitale për parandalimin e cilitdo fenomen²⁵.

Prof. Ali Pajaziti thotë se në realitetet sociale të Maqedonisë, ekzistojnë ekstremizma të natyrave të ndryshme, siç janë ultra-nacionalizmi dhe të fundit fetare që është latente dhe manifestohet ndonjëherë. Sipas Pajazitit, arsyet kryesore për zgjerimin e ekstremizmit të dhunshëm janë jostabiliteti politik i cili çon rininë drejt një qasjeje pa paerpektivë në vendlindje, kushte të këqija ekonomike dhe papunësi.

Ngjashëm me Arifin dhe Pollozhanin, Pajaziti gjithashtu vëren se përmbajtja në internet është mjaft efikase. Ai përmendi materialet vizuale (fotografi me citate që nxisin emocione, video etj.) të cilat 'formojnë një imazh të viktimave të cilat kanë nevojë për ti shpëtuar' tek rinia. Pajaziti thekson se nuk ka diskutim tek akademikët e Maqedonisë për këtë çështje. Ai gjithashtu theksoi kuptimin e mediave si të rëndësishëm për të përmirësuar diskutimet në këtë drejtim. Sipas Pajazitit, aktorët mediatik në Maqedoni ekspozojnë këtë fenomen pa ndonjë ekspertizë apo gazetari hulumtuese, dhe pa hulumtim në zyrë për 'lëvizjet ekstremiste', kulturën apo civilizimin islam, dinamikën e botës arabe, turke apo në përgjithësi botën islame.

Pajaziti u shpreh se duhet pasur arsimim institucional rreth religjioneve në shkollat e mesme, përmes teksteve mësimore të cilat janë shkruar nga ekspertë në këtë lëmi. Kjo, pohon Pajaziti, do të parandalojë ekstremizmin e dhunshëm i cili i referohet cilitdo religjion i cili është prezent në shtet.²⁶

^{25*} Intervistë me Lura Pollozhanin, Asistente studiuuese në Universitetin e Gracit, e realizuar më 21.03.2017

^{26*} Intervistë me Ali Pajaziti, profesor i Sociologjisë pranë Universitetin e UEJL, e realizuar më 10.04.2017

Fokus grupet

Duke pasur parasysh dinamikën lokale të kësaj çështjeje, ky material hulumtues ka për qëllim gjithashtu të merr në pyetje qasjen e qytetarëve lokal. Me qëllim që të shikohen më thellë lëvizjet lokale dhe situata e përgjithshme në nivel lokal, janë mbajtur tre fokus grupe në lagjet e synuara nga ky studim. Duke marrë parasysh se grupi më inë shënjestër nga propaganda e ekstremizmit të dhunshëm janë rinia, respektivisht nxënësit dhe studentët e shkollave të mesme dhe universiteteve, grupmosha për të tre grupet e fokusit ishte 18-25.

Grupet e fokusit ishin të moderuara nga hulumtuesit e këtij studimi. Ishin 6 pjesëmarrës (3 femra, 3 meshkuj) në Komunën e Çairit, 6 pjesëmarrës (4 femra, 2 meshkuj) në Komunën e Sarajit, ndërsa 4 pjesëmarrës (4 meshkuj, 2 femra nuk u paraqitën megjithëse e konfirmuan pjesëmarrjen e tyre) në lagjen e Gazi Babës.

Pjesa e parë e pyetjeve ishte e natyrës së përgjithshme, siç janë këndvështrimi i pjesëmarrësve mbi ekstremizmin e dhunshëm. Nëse diskutohet kjo temë në shoqëri dhe mendimi i tyre për shkaqet kryesore dhe nxitësit e kësaj dukurie. Pjesa e dytë e pyetjeve ishte e natyrës më specifike, duke theksuar dinamikën lokale të kësaj çështjeje.

Kështu, fokusi kryesor ishte në vërtetimet e përgjithshme të rinisë lokale mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe situata e tanishme në lagjet në fjalë. Krahas kësaj, u pyetën (nëse ka) ndonjë rast konkret të rekrutimit për të cilat kanë dëgjuar apo kanë përjetuar, pa ekspozuar identitetet e personave dhe duke u fokusuar vetëm në kushtet që kanë shkaktuar rekrutimin e tyre. Duke u bazuar në rastet, kishte diskutime të zhvilluara rreth faktorëve kryesor të shtytjes dhe tërheqjes, nxitësit dhe gjithashtu trendët lokal. Për më tepër, diskutimi kishte fokus të veçantë mbi qasjen e rinisë për mënyrat e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Një vërtetim i konsiderueshëm nga të gjitha grupet ishte se pjesëmarrësit ishin të qartë në të dalluarit e ekstremizmit të dhunshëm si fenomen i cili përfundon me rekrutim dhe radikalizim si 'fenomen i cili nuk do të thotë përfundimisht rrezik për shoqërinë, përderisa qëndron në dimensionin personal të zgjedhjeve dhe disa aktivitete të pranueshme kolektive'. Prandaj, perceptimi i përgjithshëm i tyre ishte se praktikimi i riteve themelore të një feje në hapësirë publike duhet të konsiderohet në kuadër të lirisë së religjioneve, se sa një potencial apo kërcënim ndaj sekularizmit. Përveç kësaj, niveli i ulët i besimit tek institucionet publike dhe në veçanti BFI si organi përfaqësues i bashkësisë muslimane në vend, ishin ndër gjetjet e tjera të konsiderueshme nga të gjitha grupet e fokusit. Lidhur me këtë, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve besojnë se grupet e dhunshme ekstremiste kanë lidhje hibride me agjencinë e inteligjencës të vendit. Një tjetër gjetje e dukshme me natyrë të ngjashme është se pothuajse të gjithë besojnë se kur bëhet fjalë për një vëzhgim të përgjithshëm për grupet terroriste aktive në Lindjen e Mesme, të gjitha ato keqpërdoren nga fuqitë e mëdha politike për përfitimet e tyre politike dhe ekonomike. Këto vëzhgime bazohen në disa pyetje shtesë që janë ngritur në bazë të dinamikës së diskutimit në vazhdim.

Në grupet e fokusit këtu flisni shumë shkurt, të gjitha pjesët që përdorni nga grupet e fokusit duhet të jenë këtu, jo vetëm metodologjia, kjo duhet t'ju japë më shumë gjetje. Unë kam vështirësi për të identifikuar gjetjet në letër, secili seksion duket sikur prezanton përsëri seksionin, por duke mos shkuar më thellë në paraqitjen e gjetjeve të këtij viti, vetëm faktet e mëparshme dhe besimi popullor.

Komuna e Çairit

Komuna e Çairit është komuna me dendësi më të lartë në Evropë, në aspektin e popullsisë, duke numëruar 64.773 qytetarë në 3.52 km². Në këtë aspekt, është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se ky numër zyrtar i popullsisë është nga konsensusi i fundit që në Maqedoni u krye për herë të fundit në vitin 2002. Duke pasur parasysh se në pesëmbëdhjetë vitet e fundit ka pasur ndërtime masive të ndërtesave të reja për banim brenda të njëjtës zonës të përgjithshme, konsiderohet se sasia e popullsisë është mjaft e madhe. Një fakt tjetër i rëndësishëm për komunën e Çairit është se pas konfliktit të armatosur të vitit 2001 në Maqedoni, qytetarët maqedonas etnik janë shpërngulur masivisht nga kjo lagje dhe është bërë një zonë mbizotëruese e banimit shqiptar. Është gjithashtu e dukshme që një nga xhamitë që BFI publikisht ankohej se nuk ka kontroll mbi të në vitin 2015, për shkak të okupimit të saj nga grupet ekstremiste, është Xhamia e Jahja Pashës, e vendosur në këtë komunë.

Duke qenë si grupi i parë i fokusit, pjesëmarrësit nga lagja e Çairit ishin relativisht të hapur në diskutim. Të pyetur për perceptimin e tyre mbi ‘ekstremizmin e dhunshëm’, të gjithë ata bënë deklaratatë të ngjashme duke vënë në dukje mos pranimin dhe besimin e prishjes së pikëpamjes së tjetrit si thelb të përkufizimit. Megjithatë, një nga pjesëmarrësit shprehet se ekstremizmi me referencë fetare del kur feja perceptohet si një kauzë politike, dhe jo një marrëdhënie midis “Krijuesit” dhe “krijesës”. Një nga pjesëmarrësit theksoi se fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni u bë një ‘temë e nxehtë’ në bashkësi kur Shqipëria arrestoi disa nga predikuesit fetarë në këtë drejtim. Prandaj, ata deklaruan se arrestimet e fundit në Kosovë nxitën frustrimin në bashkësinë shqiptare të Maqedonisë, për shkak të besimit të tyre se disa prej atyre predikuesve fetarë të arrestuar ishin të pafajshëm dhe nuk mund të etiketoheshin si të lidhur me ekstremizmin e dhunshëm. Sipas mendimit të tyre, është normale që rekrutimet për grupe ekstremiste të dhunshme si ISIS ose Al-Nusra të jenë fokusi kryesor kur diskutohet “ekstremizmi i dhunshëm”, për shkak të paraqitjes së tyre mediatike në nivel global dhe lokal. Megjithatë, tre nga pjesëmarrësit pohuan se ‘ekstremizmi i dhunshëm’ nuk do të thotë përfundimisht rekrutim për ta. Ata vunë në dukje protestat më të fundit të grupeve nacionaliste të së djathtës ekstreme që u zhvilluan me shumë raste të fjalimeve të urrejtjes ndaj bashkësive të ndryshme etnike në Maqedoni.

Duke marrë parasysh kushtet e rënda financiare të të rinjve në vend, disa pjesëmarrës shprehën se ekstremistët e dhunshëm e kanë përdorur këtë boshllëk duke e bërë propagandën si të ashtuquajturin ‘Shtetin Islamik’ në zonën gjeografike të Sirisë dhe Irakut, si vendin ideal për të jetuar, në të cilin ka standarde të larta të jetesës për shkak të menaxhimit financiar sipas Sheriatit (Ligji Islamik). Duke qenë kështu, vërehet se ‘gjendja financiare’ është një ‘katalizim’ i bindjes ideologjike si një faktor kryesor tërheqës.

Përveç kësaj, qasja e pjesëmarrësve ishte se Islami në bashkësinë e tyre perceptohet në mënyrë tradicionale, vetëm me atë që dëgjojnë nga prindërit dhe të afërmit e tyre, në vend që të perceptohen në bazë të hulumtimeve dhe njohurive më të thella në lidhje me të. Kështu, sipas pjesëmarrësve, bëhet shumë e lehtë për ata që të manipulohen nga qasjet ideologjike ekstremiste.

Duke u bazuar në disa raste që ata kanë dëgjuar apo dinë, pjesëmarrësit përmendën mungesën e kujdesit dhe edukimit nga prindërit si çështjen kryesore që i shkakton të rinjtë të bashkëngjiten grupeve ekstremiste. Një nga pjesëmarrësit shpjegoi një rast për një të ri nga Maqedonia që u përdor si kamikaze nga ISIS, në fushbetejën e Sirisë dhe Irakut. Sipas pjesëmarrësit, i riu ishte me një nivel të mirë të arsimit dhe gjendjes ekono-

mike, por megjithatë, ai u manipulua nga shokët e tij. Përveç kësaj, pjesëmarrësi deklaroi se jetonte vetëm, pa kaluar shumë kohë më parë me prindërit e tij. Një pjesëmarrës tjetër shprehu një rast në të cilin një student që studioje në Shkollën e Arteve u frustrua për shkak të qasjes komuniste (referuar nga pjesëmarrësi) i profesorëve dhe si protestë ndaloj arsimin e tij dhe iu bashkua grupeve ekstremiste.

Duke përmendur përvojat e tyre, pjesëmarrësit shpjeguan se qasja më e parë e grupeve ekstremiste të dhunshme tek të rinjtë në bashkësi është shumë humaniste dhe me dhembshuri. Duke qenë kështu, ata vunë re se ky është një nxitës shumë i efektshëm, veçanërisht për ata të rinj që kanë ndjenjën e mungesës së përkatësisë tek dikush apo diku. Përveç kësaj, ata shprehën se kontakti verbal, veçanërisht pas kohës së lutjes, është nxitës thelbësor që përdoret nga ekstremistët e dhunshëm në bashkësi për t'u afruar tek të rinjtë. Një nga pjesëmarrësit shpjegoi se ai kalonte shumë kohë me tre shokë, anëtarët e familjes, të afërmit ose miqtë e ngushtë të së cilëve kanë qenë apo janë aktualisht në fushëbetet e Sirisë dhe Irakut. Përveç kësaj, ai pohoi se disa nga miqtë që ai e dinte se janë të përfshirë me grupet ekstremiste janë grabitës, përdorues të drogës ose pije alkoolike dhe njëkohësisht përkrahës të ideve ekstremiste.

Së fundi, u kërkuan idetë e tyre për parandalimin e fenomenit në nivel të bashkësisë, pjesëmarrësit u shprehën se duhet të ketë OJQ që realizojnë aktivitete më të mëdha tërheqëse për rininë dhe angazhimin e tyre. Në përputhje me këtë, pjesëmarrësit shprehën se institucionet shtetërore duhet të qasen “më butë” për ndaj kësaj çështjeje, pasi “masat e rënda” në mënyrë të tërthortë kontribuojnë në zgjerimin e ekstremizmit.

Lagja e Gazi Babës

Lagja e njohur si Gazi Babë, e cila gjeografikisht është hartuar brenda komunës së Çairit dhe në vijën kufitare me komunën e Gazi Babës, është një tjetër vend i me popullsi të dendur. Është e dukshme që Rexhep Memishi, një imam i vetëshpallur që pranoi aktin e rekrutimit në gjykimin e tij dhe më pas u dënua me 7 vjet burg, mbante predikimet fetare javore të së premtes në Xhaminë Tutunsuz, që ndodhet në këtë lagje. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se Memishi nuk kishte kurrfarë leje zyrtare nga BFI për të mbajtur ato lutje javore të së premtes, që është lutja më e ndjekur nga muslimanët. Duke pasur parasysh se Memishi ishte me ndikim në këtë lagje, ishte menduar se kishte një grup fokusi të veçantë me të rinjtë, veçanërisht nga ky vend.

Gjetja më e rëndësishme nga ky fokus grup ishte se pas arrestimeve në kuadër të operacioneve Qeliza 1 dhe Qeliza 2, mbështetja për grupet e dhunshme ekstremiste në këtë lagje është pakësuar në mënyrë drastike. Bazuar në vërejtjen nga pjesëmarrësit, shumë nga miqtë e tyre përreth kanë ndërprerë lidhjet me këtë grup pas arrestimeve. Sipas tyre, kjo ndodhi për shkak të ngritjes së vetëdijes në opinionin publik për këtë çështje. Si pasojë, ndërhyrja e prindërve ndaj atyre të rinjve u bë më efektive. Megjithatë, një nga pjesëmarrësit pohoi se pas arrestimeve, numri i rekrutimit është rritur për shkak të frikës së arrestimit. Ai deklaroi se ka dy persona që ai e din se kanë shkuar në Siri deri më tani, para se të realizohej ky grup i fokusit.

Të pyetur për perceptimin e tyre të përgjithshëm për ekstremizmin e dhunshëm, një pjesëmarrës pohonte se në ditët e sotme ka të bëjë me nivelin e ideologjive që në shumicën e rasteve kryesisht tregojnë referime ndaj qasjeve ideologjike të fesë (duke praktikuar ritualet kryesore fetare sipas një shkolle të caktuar praktikimi) dhe në fund të vëje në dukje qëllimet e saj politike (duke pretenduar krijimin e një shteti fetar). Në shembul-

lin konkret të ISIS, ajo bazohet në dy parametra ideologjikë: praktika vehabiste e besimit dhe besimi i riorganizimit të muslimanëve brenda një shteti të caktuar “Hilafet”.

I pyetur nëse ekziston një profil i caktuar i grupeve ekstremiste në bashkësinë e tyre përkatëse, të gjithë pjesëmarrësit pohuan se synojnë me qëllim të rinjtë që kanë një nivel të ulët të dijes mbi fenë. Përveç kësaj, ata pohuan gjithashtu se grupet ekstremiste bëjnë një studim bazë për disa të rinj që ata synojnë, duke marrë informacion rreth familjes së të rinjve të synuar. Prandaj, kur u pyetën nëse ata e diskutojnë këtë fenomen me të afërmit apo miqtë e tyre, të gjithë pohojnë se ata kurrë nuk kanë folur në shtëpi, por shpesh me miqtë e tyre.

I pyetur për disa raste konkrete që mund të kishin përjetuar, një nga pjesëmarrësit shprehu se kishte humbur tre miq në fushbetejat e Sirisë dhe Irakut, që jetonin në të njëjtën lagje. Ai deklaroi se të gjithë ata shkuan atje për shkak të bindjes së tyre ideologjike për të formuar një Shtet të ashtuquajtur Islamik. Megjithatë, ai përmendi se frustrimi që ata po merrnin pas shikimit të videove të torturave të orkestruara nga regjimi i Asadit dhe duke dëgjuar predikimet e vetëshpallura të imamit për të njëjtin kontekst, ishin një motivim vendimtar për ata që të vendosnin për t'u bashkuar me kundërvënien. Ndërsa dy prej tyre ishin 23 vjeç, njëri prej tyre ishte më i madh (duke mos specifikuar moshën). Përveç kësaj, ai përmendi se tre prej tyre kishin probleme me familjet e tyre para se të shkonin atje. Prandaj, njëri prej tyre shkoi pasi ai u nda me të fejuarën e tij, rasti për shkak të familjes së tij personale e kishte distancuar atë nga shtëpia.

Një rast tjetër i shpjeguar nga një pjesëmarrës ishte i befasueshëm edhe për vetë pjesëmarrësin, sepse ai deklaroi se ata u takuan për një kafe një natë para se ai të shkonte në Siri. Ish luftëtarit nuk i kishte përmendur asgjë pjesëmarrësit për planin e tij për të shkuar atje. Megjithatë, sipas pjesëmarrësit, ai ishte penduar shumë që kishte marrë pjesë, por sapo u kthye në atdhe, ai u arrestua.

Njëri nga pjesëmarrësit deklaroi se kur shkoi në një vizitë ngushëlluese tek njëri nga luftëtarët e huaj që vdiqën në fushën e betejës, babai i tij ndihej krenar me djalin e tij. Megjithatë, pas një kohe, i njëjti prind i sugjeroi të rinjtë të mos bënin atë që kishte bërë i biri i tij dhe rreptësisht të mos bashkohen me grupet e dhunshme ekstremiste.

Përveç kësaj, një pjesëmarrës tjetër shprehu se ka një mik që është kthyer nga fushëbeteja dhe tani është arrestuar. Në përputhje me këtë, ai tha se ka shumë të tjerë që duan të kthehen pasi që janë penduar që kanë marrë pjesë në grupe ekstremiste të dhunshme, por kanë frikë se do të arrestohen sapo të kthehen.

Një pjesëmarrës shpjegoi se ndalimi i dhomave të lutjes në shkollat e mesme për nxënësit që dëshironin të praktikonin ritualet kishte efekt negativ dhe i frustronte ataduke i bërë ata kundër stafit shkollor. Ai pohoi se tre prej nxënësve që ai i kishte takuar në dhomën e lutjes më parë, filluan të përfshiheshin në grupe ekstremiste të dhunshme dhe të ndryshonin qëndrimin e tyre ndaj mësuesve të tyre.

Një tjetër rast i dukshëm është se një nga pjesëmarrësit kishte një shok që është kthyer nga fushbeteja në Siri. Ky ish-luftëtar i shpjegoi se kishte vrarë një luftëtar në fushën e betejës dhe pasi hapi xhepin e luftëtarit që kishte vrarë, ai gjeti një Kur'an të vogël në xhep. Kjo e ka bërë me shumë keqardhje dhe kështu, ai filloi të mendojë se po keqpërdoret nga ISIS. Më pas, ish-luftëtarit deklaroi se ai u arratis nga atje, sepse nëse dikush kuptonte se ai po kërkon mënyra për t'u larguar, ata ekzekutohen para publikut.

Një gjetje interesante nga ky fokus grup ishte se stigmatizimi i bashkësisë ndaj disa grupeve të caktuara njerëzish, si ata me nevoja të veçanta, me sëmundje alkoolike, njerëz të divorcuar etj., mund të jenë faktor shtytës drejt ekstremizmit të dhunshëm. Një nga

pjesëmarrësit shpjegoi se një luftëtar i huaj mori vëllanë e vet në fushën e betejës me vete vetëm për shkak se fqinjët talleshin me vëllain e tij për shkak se ishte me sindromën e Daunit.

Njëri nga pjesëmarrësit pohoi se largimi nga miqtë që fillojnë të radikalizohen, në mënyrë indirekte ndihmon në përshpejtimin e procesit të radikalizimit. Ai e argumentoi këtë me një rast për vëllain e tij. Sipas rastit, vëllai i pjesëmarrësit filloi të largojë një shok që filloi të bashkohej me grupet ekstremiste të dhunshme. Megjithatë, para se të largoheshin fare, ata po diskutonin rreth rekrutimeve. Personi i radikalizuar i shpjegoi atij se vëllai i tij ka shkuar në Siri dhe nëse do të mundte dhe ai do të bënte të njëjtën gjë. Ai gjithashtu shpjegoi se para se vëllai i tij të shkonte atje, ai u dha një shumë të madhe parash familjes që ai mori nga grupe ekstremiste të dhunshme.

Të pyetur nëse ekziston një bazë e përbashkët e ekstremistëve të dhunshëm në lagjen e tyre, një nga pjesëmarrësit pohoi se grupet ekstremiste janë bërë më “nëntokësore” pas operacioneve Qeliza 1 dhe Qeliza 2. Një trend i konsiderueshëm është se sipas një pjesëmarrësi, mënyra e re e bisedës është përmes sistemit Sony Play Station në internet. Një tjetër pretendim interesant ishte se ata gjithashtu bisedonin përmes letrave të sanduiçëve në vendet e ushqimit të shpejtë në lagje. Një tjetër prirje e përmendur ishte se rekrutimet ndodhën kryesisht gjatë dhjetë ditëve të fundit të muajit të agjërimit të Ramazanit, pasi ato konsiderohen si ditë më emocionale.

Së fundi, disa nga pjesëmarrësit pohuan se nevojitet një strategji kombëtare specifike për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në të cilin sipas planit të saj të veprimit duhet të parashikohen aktivitete të përbashkëta të bashkësive fetare, OJQ-ve dhe shkollave të mesme për ngritjen e vetëdijes për këtë fenomen.

Komuna e Sarajit

Komuna e Sarajit është komuna më e madhe e Shkupit, me një sipërfaqe totale prej 229.06 km² dhe një popullsi totale prej 35,408²⁷. Sipas informacionit demografik, ka (sipas përqindjes) 91.5% shqiptarë, 3,9% maqedonas, 3,2% boshnjakë dhe 1,4% të tjerë.

Në krahasim me grupet e tjera të fokusit, pjesëmarrësit e këtij grupi të fokusit deklaruan se ata debatojnë për ekstremizmin e dhunshëm me familjet e tyre, pasi ka shumë të rinj që janë të prekur nga ky fenomen në bashkësinë e tyre. Megjithatë, pjesëmarrësit pohuan se grupet ekstremiste të dhunshme zakonisht u drejtohen personave me nivel të ulët arsimimi dhe që janë të prekshëm në aspektin social.

Një pjesëmarrëse tjetër shprehu se ata kanë folur për këtë fenomen me familjen e saj, pasi një nga mësuesit e saj u përpoq t'i kufizojë aktivitetet e saj feministe. Ajo gjithashtu pohoi se profesori i provokoi studentët duke thënë se femrat nuk duhet të arsimohen në shkollë dhe nuk duhet të kenë kontakt me meshkujt. Për më tepër, një pjesëmarrës tjetër deklaroi se një profesor në shkollën e mesme ku ajo po mësonte (Arseni Jovkov Shkolla e mesme e ekonomisë dhe drejtësisë) shpërndau disa fletushka me përmbajtje se cilat janë dënimet në ferr. Në diskutimet e mëtutjeshme për këtë, u vërejt se nxënësit pajtohen me pranimin e sugjerimeve fetare në aspektin pozitiv, por jo në natyrën e lartpërmendur, siç janë dënimet apo deklaratat e tjera dekurajuese.

^{27*} Ky numër është sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2002 të Rep. së Maqedonisë, i qasur në: http://www.stat.gov.mk/pdf/kniga_13.pdf

Pjesëmarrësit vërejnë se ndërgjegjësimi, mungesa e arsimit, varfëria, njohuria e paktë fetare, vetmia, segregimi nga shoqëria janë faktorët kryesorë që një i ri ndikohet nga ekstremizmi i dhunshëm. Ata gjithashtu thanë se nxitësit kryesorë të rekrutimit në bashkësitë e tyre janë aktivitetet në natyrë si piknikët dhe udhëtimet. Një pjesëmarrës u shpreh se ka pasur disa raste në të cilat grupet ekstremiste kanë ndihmuar disa të rinj të varfër në ndërtimin e shtëpive të tyre ose blerjen e makinave.

Megjithatë, pjesëmarrësit gjithashtu përmendën ekstremizmin në internet si një nxitës shumë i rëndësishëm. Një pjesëmarrës u shpreh se një femër nga kjo bashkësi ka filluar kontaktet e saj të para përmes Facebook-ut. Pjesëmarrësi gjithashtu pohoi se ajo ishte kapur nga policia gjatë përpjekjes për të shkuar në Siri. Ajo u kritikua shumë nga familja dhe të afërmit e saj, por megjithatë, ajo nuk i ndaloi aktivitetet e saj ekstremiste dhe rekrutoi dy shoqe të tjerë, që sipas pjesëmarrësit, tre prej tyre u përdhuan nga ata ekstremistë. Për shkak të kësaj, sipas pjesëmarrësit, ajo u përpoq të bënte vetëvrasje në atë periudhë.

Një pjesëmarrës tjetër deklaroi se kushëriri i saj po dëgjonte vazhdimisht predikimet e Rexhep Memishit që janë ende në dispozicion në internet. Ajo vuri re shumë ndryshime në sjelljen e tij. Përveç kësaj, ajo shprehu që pas një kohe ai krijoi një grup me shokë, në mënyrë që të marrin pjesë në aktivitetet në natyrë të ekstremistëve të dhunshëm. Për më tepër, ajo pohoi se ai është duke u paguar për këtë nga grupet ekstremiste. Ajo shtoi se ai madje e ka ndalur shkollimin e shkollës së mesme dhe nuk ka mbaruar akoma.

Një gjetje e konsiderueshme ishte se korniza kohore më efektive e kontaktit të të rinjve me grupe ekstremiste është gjatë pushimeve verore. Sipas një pjesëmarrësi, një nga shokët e tij të klasës ishte miqësor, i qetë por megjithatë, ai përjetoi shumë ndryshime gjatë kohës së verës. Ai filloi të rritet mjekrën e tij dhe ndryshoi stilin e tij të veshjes në përgjithësi. Ai gjithashtu filloi të mos flasë fare me femrat, megjithëse ai ishte mjaft i hapur me ta më parë.

Të pyetur nëse ekziston një bazë e përbashkët ekstremiste në të cilën ata mblidhen në bashkësinë e tyre, pjesëmarrësit pohuan se ka disa dhoma joformale për lutje të përdorura si 'xhami alternative'. Të pyetur se përse pikërisht Shkupi dhe në veçanti bashkësia e tyre janë prekur nga ky fenomen, pjesëmarrësit deklaruan se edhe pse bashkësia e tyre është më e madhja në aspektin e territorit, ajo perceptohet si rurale për shkak të qeverisjes së dobët lokale. Kjo situatë i ka sjellë në mungesë të mundësive dhe të jenë të prekshëm ndaj grupeve ekstremiste.

Së fundmi, pjesëmarrësit deklaruan se duhet të ketë mësim mbi besimet në shkollat ku nxënësit mund të marrin njohuri rreth feve nga burimi i vërtetë. Një tjetër sugjerim lidhur me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm ishte mbështetja e aktiviteteve në natyrë përmes OJQ-ve aktive në bashkësi.

Propaganda në internet

Kjo pjesë përqipet të shqyrtojë propagandën ekstremiste në internet që synon individë nga Maqedonia dhe Ballkani Perëndimor. Kjo bëhet duke ndjekur aktivitetet e platformave të mediave sociale, si Twitter, Facebook dhe YouTube, ku ne do të përqipemi të zbulojmë çdo propagandë ekstremiste të mundshme. Pas gjetjes së propagandës ekstremiste, hulumtuesit tanë paraqesin përmbajtjen tek ekipet përkatëse të medias sociale me qëllim që përmbajtja të hiqet nga interneti. Ekzaminimi i propagandës së mediave sociale është gjithashtu i rëndësishëm, pasi na jep një pasqyrë në mesazhet, tregimet dhe mjetet që ekstremistët përdorin kur adresojnë rekrutë dhe pasues potencialë. Kjo siguron një ide më të mirë për politikbërësit se si funksionojnë faktorët tërheqës për radikalizimin, e cila na ana e tyre lejon një përgjigje më të mirë dhe më të informuar për ta.

Pyetjet që shqyrtojmë në këtë pjesë janë:

- Çfarë platformash përdorin ekstremistët për komunikim me pasuesit e tyre dhe rekrutët e mundshëm?
- Sa të shpejtë dhe efektiv janë ekipet përkatëse të medias sociale për t'iu përgjigjur kërkesës tonë për heqjen e përmbajtjes?
- Çfarë janë llojet e mesazheve që dërgojnë ekstremistët?

Bazuar në intervistat dhe fokus grupet, vërehet se grupet e dhunshme ekstremiste e përdorin Facebook-un në mënyrë aktive si një mjet komunikimi me pasuesit e tyre. Ka disa profile të rreme duke përdorur emrat dhe mbiemrat që nuk ekzistojnë për të mos u identifikuar. Përmbajtja e materialeve të përdorura në mediat sociale ndryshon nga publiku i saj. Përmbajtja e videove në YouTube është më në synim për pasuesit e vetë grupit. Përkatësisht, ka shumë materiale 'online' të identifikuara si një mënyrë e hapur për rekrutim ose propagandë të grupit në YouTube. Është vërejtur se thirrjet për t'u bashkuar në fushbetejat në Siri dhe Irak janë më të dukshme. Ka edhe disa video që shfaqin jetën e përditshme në të ashtuquajturin 'Shtet Islamik', ku të rinjtë inkurajohen të bashkohen me autoritetin e Kalifës (Kreu Islamik). Këngët fetare me vargje të cilat inkurajojnë kundërvënien, shfaqja e flakës së ISIS-it, skenat nga filmat me përmbajtje të luftës, predikimet fetare me momente emocionale që nganjëherë duket se janë përkthyer në arabisht (në rast se predikimi nuk është nga një predikues lokal), janë disa nga elementët e përbashkëta të këtyre videove.

1 Figura 1: YouTube kanal me propagandë për ISIS





Figura 2: Video në YouTube me propagandë për regrutime në ISIS



Nga ana tjetër, përmbajtja në faqet e Facebook është më shumë për një audiencë më të gjerë njerëzish, në të cilën fokusi kryesor i mesazheve është në përgjithësi mizoria e zotëruar nga regjimi i Asadit. Ka shumë video emocionale nga shpërthimet, sekuenca nga shtëpitë e shkatërruara, fëmijët që vdesin nga uria, dhe tekste nga dijetarë që kryesisht referohen nga grupet ekstremiste.

Një tjetër gjetje e konsiderueshme është titulli i përmbajtjes. Ndërsa titujt e kanaleve dhe videove të YouTube janë më konciz në lidhje me rekrutimet, titujt e faqeve dhe videove në Facebook janë më shumë për vlerat e përgjithshme të Islamit. Me anë të kësaj vërehet se audiencia e synuar në Youtube është ndjekësit ekstremistë, ndërsa në Facebook është kryesisht e gjithë bashkësia muslimane.

Figura 3: Faqe në Facebook me propagandë të fshehur për ISIS




Disa nga kanalet YouTube, videot dhe faqet e Facebook janë si më poshtë:

| PLATFORMA | EMRI I PËRMBAJTJES | LLOJI I PËRMBAJTJES |
|------------------|---|----------------------------|
| Youtube | Siria mes hadithit dhe realitetit | Video |
| Youtube | Ghuraba | Video |
| Youtube | Zgjhuni o Muslimanë! | Video |
| Youtube | Minbermedia | Kanal |
| Youtube | Agimi i Vërtetë | Kanal |
| Youtube | Rrezet e Dritës | Kanal |
| Youtube | Krenaria Islame | Kanal |
| Youtube | Minarja e Bardhë | Kanal |
| Youtube | Islami i Vërtetë | Kanal |
| Facebook | E Vërteta e Qartë | Faqe |
| Facebook | Hilafeti | Faqe |
| Facebook | E Vërteta e Qartë 2 | Faqe |
| Facebook | Lajme nga Vendi | Faqe |
| Facebook | Ligji i Allahut është Dritë | Faqe |
| Youtube | Këngë për Osama Bin Laden në shqip | Video |
| Youtube | EbuAbdulalim | Kanal |
| Youtube | Mesime Teuhidi | Kanal |
| Youtube | Cila eshte e verteta per xihadin ne Afganistan dhe ne Irak? | Video |
| Youtube | Këngë | Video |
| Youtube | Luanet e umetit | Video |
| Youtube | Viedoislameteam | Kanal |
| Youtube | Ju pershendes me lot ne sy | Video |

Një tjetër gjetje e konsiderueshme është se kanali i YouTube i titulluar “Mësimet Tevhidi” ngarkon video me përkthim në gjuhën shqipe nga predikuesi fetar i vetëshpallur Halis Bayuncuk (i shpallur si Ebu Hanzala nga ISIS).

Figura 4: Ligjërime të Halis Bajunxhuk, prijës i ISIS në Turqi



Identifikimi i lartpërmendur dhe raportimi i përmbajtjes në YouTube dhe Facebook, është bërë në një periudhë kohore prej një muaji. Duke u bazuar në përditësimet e fundit, nga të gjitha të raportuarat, 5 faqe të Facebook-ut, 3 kanale në YouTube dhe 8 video veç më janë larguar nga platformat e mediave sociale në fjalë.

Transkriptimi i disa përmbajtjeve të videove të cilat inkurajojnë rekrutim tek grupet ekstreme janë si vijojnë:

Video: “Siria midis hadithit (citate të Profetit Muhammed) dhe realiteti”

Predikues: Rexhep Memishi

E ngarkuar: Qershor 2013

Sekuencë:

“Ne kemi thënë në shumë ligjërata se Shami ka përjetuar kurthe të mëdha nga armiqtë e Islamit, Shami, ajo tokë e frytshme dhe e bekuar, vendi ku do të mblidhen muslimanët para Ditës së Gjykimit dhe vendi i cili është thënë të jetë toka e luftimeve, e shokëve të Allahut, vendi i burrave musliman... Gjerat që i shohim sot aty janë kulminimi i asaj që është e njohur si Pranvera Arabe, është kulminimi i tiranëve mizor të cilët nuk i ka parë historia më parë, kundër mizorëve të cilët ushqehen me gjakun e fëmijëve musliman ... A mendoni se Zoti do të linte që ky gjak të mposhtet?! A mendoni se Zoti do të le gjakun e luftëtarëve në këtë vend të shenjtë i cili është i mbrojtur nga Ai?! Nuk ka hadithe (citate të Profetit Muhammed) për një vend më shumë se sa për Shamin. Ibn Tejmije ka shkruar një libër të veçantë për Shamin dhe ka jetuar atje ...

Profeti Muhammed asnjëherë nuk ka folur me emocione ose hamendje, njëjtë sikur që disa mendojnë se luftëtarët në rrugën e Zotit janë njerëz të emocioneve dhe vetëm zbatues të planeve të armiqve, njëjtë si që i thërrasin muxhahedinët dhe shokët w Zotit të cilët janë tani në vendin ku luftojnë për Zotin ...

Kurdo që shohin fëmijë gra të vrarë, ose pleq të mposhtur, kur shohin njerëz të varfër, ata shkojnë dhe luftojnë për hir të Zotit, por ata janë të quajtur nga të tjerët terrorist, si vrasës fatkeqësisht edhe nga muslimanët.

Ndodhitë në atë vend janë vitale, dhe çka po shoh deri tash është, në mendimin tim një luftë e frytshme. Kjo është një luftë e madhe, është një fitne (nxitje) e kësaj bote por lavdërim për muslimanët. Sidoqoftë, pasi që kjo është kohë e fitneve, muslimanët duhet të jenë të kujdesshëm pasi që mund të mos dinë se në cilën anë duhet të jenë. Ne nuk duhet të jemi në anën e mosbesimtarëve, të mosbesimtarëve shqipfolës, të njerëzve që përpigën të tregojnë veten si hoxhallarë, ata hoxhallarë tll cilët në emër të islamit, ndjekin rrugën e Dexhahallit (Anti-Krishtit). Pra, a do të përcillni Dexhahallin?”

Video: “Zgjuhuni o musliman!”

Predikues: Shukri Aliu

E ngarkuar: Shkurt 2012

“Shembulli i ummetit tonë është si anija, por kjo anije nuk lundron në ujin e detit, por në gjakun e djemve të saj, kurdo që të zhduhet gjaku, anija fillon të dridhet dhe kurdo që gjaku të thahet, anija copëtohet. Dhe kjo është pse ummeti ynë është i copëtuar, sepse gjaku i (shehidëve) martirëve tanë në emër të Zotit është copëtuar. Fryti i quajtur Islam rritet me gjakun e shehidëve (martirëve) kur do që të os derdhim ujë në trungun e saj, fryti i Islamit fillon të thahet.”

Video: “Pyetje dhe përgjigje”

Predikues: Rexhep Memishi

E ngarkuar: Mars 2011

“PYETJE: A mendoni se ngjarjet e fundit në tokat islame janë çështje e hebrejve dhe krishterëve, duke pasë parasysh se ata nuk kanë reaguar ende?

PËRGJIGJE: Në lidhje me ngjarjet e fundit, i lutemi Allahut të ndihmojë muslimanët kudo që të jenë, lutemi që fjala e Tij të jetë më e larta ndërsa ajo e jobesimtarëve të jetë më e ulta. Mosbesimtarët kanë me të vërtetë plane dhe reagime, ka reagime... Friga e tyre më e madhe është të mos lejojnë muslimanët të marrin sundimin kështu që Sheriati i Allahut të sundojë atje. Ata dëshirojnë që të lënë sistemet, siç i quajnë ata ‘demokraci’. Ata dëshirojnë që ato vende ende të jenë koloni të Perëndimit, kështu që bekimet në këtë vend të ngelin në favor të perëndimit, por Allahu është Ai që do ti mposht ata dhe duke u bazuar në atë që ka thënë Profeti Muhammed se këto janë fazat e fundit, para ditës së Gjykimit, sepse është sistemi i tiranisë dhe pastaj do të pasohet nga Hilafeti (lloj islamik i sundimit), njëjtë si në kohën e Profetit Muhammed dhe pasuesve të tij Ebu Bekrit, Omerit, Osmanit dhe Aliut. I lutemi Allahut që ato toka të transformohen në sundime nga të cilat Ai do të jetë i kënaqur, andaj i lutemi Allahut që muslimanët të përdorin këtë moment historik, ne nuk i ndalojmë muslimanët të mos shkojnë, dhe t’u ndihmojnë për ndryshimin e diktatorëve që luftojnë islamit dhe muslimanët, që u bëjnë tradhëti dhe kurthe...

PYETJE: Nëse dikush dëshiron të bëhet martir dhe shkon në luftë me këtë qëllim, a do t'ia pranon Allahu lutjen? Frigohem të vdes në mënyrë të thjeshtë, dëshiroj të jap jetën time për hir të Allahut kështu që Allahu të jetë i kënaqur me mua dhe dëshira ime është e tillë dhe jo ndryshe. Por sidoqoftë, e di se prindërit e mi nuk do të më lejonin të bëj diçka të këtillë. Nëse shkoj atje, a është hallall (e lejuar me parimet islame)?

PËRGJIGJE: Profeti Muhammed ka thënë se shehidët (martirët) janë shumë. Ai ka thënë se kushdo që kërkon të jetë shehid me një sinqeritet të madh, Allahu do të mundësojë që ai/ajo edhe nëse vdes në krevat. Kjo është çka ka thënë Profeti për ata që dëshirojnë të arrijnë këtë shkallë, pra është një shkallë të cilët njerëz i ka lavdëruar Allahu. Zoti ka thënë në Kur'an se kushdo që respekton Allahun dhe Profetin, ata do të jenë me ata të cilët Allahu i ka mëshiruar me njerëzit e mirë siç janë shehidët dhe profetët. Ata janë njerëz të zgjedhur, besimtarët duhet gjithmonë të synojnë këtë shkallë, sepse vetë Profeti ka thënë se kulminimi i Islamit është rruga e luftimit për Allah. I lutemi Allahut që të na bëjë nga ata shehid me të cilët Allahu do të jetë i kënaqur në këtë botë dhe në tjetrën.”

Duke u bazuar në deklaratat e lartpërmendura, qartë duket se predikuesit e vetëshpallur tregojnë një tendencë për të inkurajuar dhe rekrutuar njerëz për luftimet në Siri. Kjo qartë shfuqizon nenin 322-a të Kodit Penal të Maqedonisë²⁸. Është gjithashtu e rëndësishme që të përmendet se lidhja emocionale është e shkaktuar përmes qasjeve ideologjike tek burimet fetare. Kështu, propaganda në internet. Si një nxitës i rëndësishëm drejt bindjes ideologjike, një faktor shtytës i procesit të radikalizimit, është një vegël e shpeshtë që përdoret për t'iu qasur masave.

Kur është fjala për mekanizmat e tanishëm parandalues, Ministria e Punëve të Brendshme në Maqedoni ka hapur një platformë të re në internet në faqen e saj zyrtare, të titulluar si “Pulla e kuqe”, që synon të raportojë për çdo përmbajtje relevante në internet që kategorizohen si më poshtë:

1. Keqpërdorimi i fëmijëve
2. Trafikimi me qenie njerëzore
3. Gjuha e urrejtjes apo thirrja për dhunë

Duke pasur parasysh përmbajtjen e lartpërmendur, është e rëndësishme të përfshihet ekstremizmi i dhunshëm si një kategori specifike për këtë pullë. Përcaktimi i këtij lloji të përmbajtjes në internet është me rëndësi jetike për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë për këtë fenomen në Maqedoni.

^{28*} Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, i gjetur në: <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/unpan016120.pdf>

Sondazhi mbi Kundërvënien e Ekstremizmit të Dhunshëm

Ky seksion i raportit fokusohet në analizimin e rezultateve të sondazhit të opinionit mbi dinamikën shoqërore të ekstremizmit të dhunshëm. Sondazhi synon të marrë një kuptim më të thellë të qasjes së bashkësisë në lidhje me këtë fenomen. Për më tepër, ai gjithashtu përpigjet të identifikojë nivelin aktual të qëndrueshmërisë së bashkësisë. Sondazhi përpigjet të japë një mendim publik të përgjithshëm të bashkësisë rreth elementëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me situatën aktuale kur është fjala për ekstremizmin e dhunshëm.

Sondazhi përbëhet nga 36 pyetje. Pas pyetjeve demografike (gjinia, mosha e grupit, niveli i arsimit, përkatësia etnike, statusi social, të ardhurat mujore), ka pasur disa pyetje të përgjithshme rreth situatës aktuale në vend (çështja më e rëndësishme, aderimi euro-atlantik, influenza e huaj, feja etj.). Lidhur me këtë, pjesa e fundit e pyetësorit përqendrohet në tema specifike që lidhen me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm (faktorë, nxitës, qëndrueshmëri, risocializim, kthim të luftëtarëve të huaj, pasoja ligjore etj.).

Ky sondazh u krye në tri komunat e synuara të këtij raporti. U krye me 1050 mostra, respektivisht 350 mostra për çdo komunë, që përbëhej nga të gjitha grupmoshat, prejardhjet etnike, dhe zonat urbane dhe rurale. Periudha në të cilën u zhvillua sondazhi ishte 29 nëntor - 3 dhjetor.

INFORMATA DEMOGRAFIKE

Profili demografik i numrit të përgjithshëm të respondentëve ishte si më poshtë: 47% e të anketuarve ishin femra, ndërsa 53% ishin meshkuj. Përsa i përket moshave të grupit, 6.6% ishin 20 ose më të rinj, 30.9% prej tyre ishin 21 deri në 35 vjeç, 35% ishin 36 deri në 50 vjeç dhe 27.6% prej tyre ishin 50 ose më të vjetër. Të anketuarit ishin kryesisht me arsim të mesëm të kryer (63%), pasuar nga ata me diplomë universitare të përfunduar (18.5%). Vetëm 2.3% e tyre kanë diplomë pasuniversitare. Sa i përket përkatësisë etnike, 52% e të anketuarve u deklaruan si shqiptarë, 39% maqedonas, 3.4% turq, 1.7% boshnjakë dhe 3.9% të regjistruar si të tjerë.

Të anketuarit ishin nga statuse të ndryshme shoqërore. Përderisa 33,6% e të anketuarve ishin të punësuar në sektorin privat dhe 13% në sektorin publik, 27,8% e tyre ishin të papunë. Përqindja e personave në pension ishte 11, 4%, dhe studentët ishin 6, 9%.


Rezultatet e të dhënave dhe analiza

SITUATA E PËRGJITHSHME NË VEND

Të anketuarve u është kërkuar të japin mendimin e tyre për disa tema që kanë të bëjnë me situatën aktuale politike në vend. Kështu, në pyetjen se cili është problemi më i rëndësishëm që duhet të zgjidhet në Maqedoni, gjysma e të anketuarve kanë përmendur papunësinë (25.2%) dhe ekonominë (25%). Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se shumica e këtyre përgjigjeve erdhën nga grupmosha 21 deri në 35 vjeç.


“Sipas mendimit tuaj, cili është problemi më urgjent i shtetit që duhet të zgjidhet?”

Grafika 1: Rezultate nga pyetja “Sipas mendimit tuaj, cili është problemi më urgjent i shtetit që duhet të zgjidhet?”



“Sipas mendimit tuaj, cili është rreziku më i madhë i sigurisë që ballafaqon shtetin?”

Grafika 2: Rezultate nga pyetja “Sipas mendimit tuaj, cili është rreziku më i madhë i sigurisë që ballafaqon shtetin?”




Ndërkohë, shumica e të anketuarve (83%) besojnë se Maqedonia është një vend multietnik. Të pyetur nëse Maqedonia është një vend i sigurt për të jetuar, 58% e tyre u përgjigjën pozitivisht. Sipas pikëpamjeve të tyre, paqëndrueshmëria politike (46%) dhe konfliktet mes grupeve etnike (28.5%) janë kërcënimet më të mëdha të sigurisë të vendit. Ekstremizmi nacionalist i dhunshëm (8.4%) dhe grupet terroriste ndërkombëtare (3%) ishin ndër kërcënimet e tjera të sigurisë. Të pyetur nëse e konsiderojnë NATO-n si një organizatë ndërkombëtare që mund të ndihmojë në zgjidhjen e këtyre kërcënimeve, 60% e të anketuarve konfirmuan se do të mundte. Lidhur me këtë, 78.6% e të anketuarve mbështesin integrimin e Maqedonisë në NATO. Kështu, mbështetja për integrimin në BE u llogarit si 83.5%.

NDIKIMI I HUAJ

Sipas të anketuarve, vendet që kryesisht i japin ndihmë Maqedonisë janë Turqia (33.6%), BE (24.8%) dhe SHBA (15%). Lidhur me këtë, 42.4% e tyre besojnë se Turqia është aleati më i madh i vendit, ndjekur nga SHBA (22.6%) dhe Gjermania (9.4%). Megjithatë, 47% besojnë se “Maqedonia i përket perëndimit”, 11.3% mendojnë se Maqedonia i përket Lindjes dhe 24.3% deklarojnë se “Maqedonia nuk i përket as Perëndimit, as Lindjes”. Kjo tregon se në përgjithësi, bashkësia në Maqedoni nuk e percepton Turqinë si një vend lindor.


“Sipas mendimit tuaj, cili nga shtetet në listë është aleati më i madh i Maqedonisë?”

1 Grafika 3: Rezultate nga pyetja “Sipas mendimit tuaj, cili nga shtetet në listë është aleati më i madh i Maqedonisë?”



“Cili prononcim është më afër mendimit tuaj?”

Grafika 4: Rezultate nga pyetja “Cili prononcim është më afër mendimit tuaj?”


**FEJA**

Të pyetur për zgjedhjen e fjalisë që përshkruan më së miri qëndrimin e tyre ndaj fesë, 54% e të anketuarve deklaruan se feja është e rëndësishme për ta dhe ata e konsiderojnë veten si fetarë. Ndërsa, 23% deklaruan se janë fetarë dhe pranojnë gjithçka që mëson feja e tyre. Gjithashtu, 19% deklaruan se nuk janë fetarë, por feja është e rëndësishme për ta. Për të përmblodhur, në 96% të të anketuarve, feja është e konsiderueshme në jetën e tyre. Vetëm 2% e të anketuarve deklaruan veten si jo fetarë dhe qenë kundër tij (2% nuk kishin përgjigje). Megjithatë, nëse ata duhet të zgjedhin mes shtetit sekular dhe fetar, 64.3% e të gjithë të anketuarve preferojnë sekular, ndërsa 20.8% preferojnë fetar (15% nuk kanë “përgjigje”).

Të pyetur për të vlerësuar rëndësinë e bashkësive fetare, 20% e konsiderojnë atë si të lartë, ndërsa 45% e të anketuarve e konsiderojnë si të rëndësishëm, por jo shumë të tepruar. Prandaj, 38.3% e të anketuarve mendojnë se Maqedonia duhet të sigurojë një status ligjor si institucione publike, respektivisht për Bashkësinë Ortodokse Maqedonase dhe Bashkësinë Fetare Islame. Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se 29% janë përgjigjur negativisht dhe 26% nuk kanë pasur përgjigje në këtë pyetje. Lidhur me këtë, 55% e të anketuarve mendojnë se feja luan një rol në politikën e Maqedonisë, ndërsa 31% mendojnë të kundërtën.

“A mendoni se Maqedonia duhet t’ju siguron status juridik si institucion shtetëror bashkësive fetare Kishës Ortodokse Maqedonase dhe Bashkësisë Fetare Islame?”

Grafika 5: Rezultate nga pyetja “A mendoni se Maqedonia duhet t’ju siguron status juridik si institucion shtetëror bashkësive fetare Kishës Ortodokse Maqedonase dhe Bashkësisë Fetare Islame?”



EKSTREMIZMI I DHUNSHËM


Një numër pyetjesh rreth ekstremizmit të dhunshëm, konkretisht me fokus në ISIS, u janë parashtruar të anketuarve. Sipas rezultateve, gjysma e të anketuarve e konsiderojnë ISIS-in si një kërcënim për Maqedoninë (kërcënim shumë i madh - 20.5% dhe kërcënim i madh 27.4%), ndërsa gjysma tjetër mendon se nuk është dhe aq (jo një kërcënim i rëndësishëm - 31.4% dhe jo një kërcënim aspak - 15.3%). Një diferencë e konsiderueshme në këtë drejtim është se 64% e maqedonasve e konsiderojnë ISIS-in si një kërcënim shumë të madh apo të madh, ndërsa 59% e shqiptarëve nuk e konsiderojnë situatën si kërcënuese.

Të pyetur se në çfarë mase i konsiderojnë masat e shtetit për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, 43% i konsiderojnë ato shumë efektive ose disi efektive. Nga ana tjetër, 44% e të anketuarve konsiderojnë se masat e Bashkësisë Islame Fetare për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm janë më pak efektive ose nuk janë aspak efektive.


Një gjetje e konsiderueshme nga ky sondazh i opinionit është se bashkësia në këto tri komuna bën një dallim të qartë të ISIS-it dhe fesë. Sipas rezultateve, 60.2% e të anketuarve nuk e konsiderojnë ISIS-in si grup fetar, ndërsa 21.2% e konsiderojnë atë si të tillë (18.6% nuk kanë pasur përgjigje). Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se 75% e të anketuarve nga Komuna e Çairit iu përgjigjën me “jo” pyetjes nëse ata e konsiderojnë ISIS-in si një grup fetar.

“Në cilën masë mendoni se grupat ekstremiste të dhunshme si ISIS janë rrezik për Maqedoninë?”


Grafika 6: Rezultate nga pyetja “Në cilën masë mendoni se grupat ekstremiste të dhunshme si ISIS janë rrezik për Maqedoninë?”



Grafika 6.1: Rezultate sipas komunave




Grafika 6.2: Rezultate sipas përkatësisë etnike




“A e Konsideroni ISIS-in si grup religjioz?”


1 Grafika 7: Rezultate nga pyetja “A e Konsideroni ISIS-in si grup religjioz?”



1 Grafika 7.1: Rezultate sipas komunave



1 Grafika 7.2: Rezultate sipas përkatësisë etnike



Të pyetur për të treguar faktorët më të rëndësishëm që shkaktojnë që të rinjtë të bashkohen me ISIS-in, arsyt ekonomike (47.9%), bindja ideologjike (24.7%) dhe mungesa e arsimit (10.1%) ishin tre përgjigjet më të përgjigjura midis tetë opsioneve. Kur bëhet fjalë për nxitësit e ekstremizmit, 29.5% e të anketuarve kanë theksuar se propaganda në internet (media sociale, video kanale etj.) janë mënyra më efektive e përdorur nga ISIS për të përhapur ideologjinë dhe rekrutimin e të rinjve. Nxitësi i dytë më i rëndësishëm ishte fjalimet joformale në xhami të bëra nga imamët e vetëshpallur (27.1%). Rrjeti i miqësisë mbetet si drejtuesi i tretë më i efektshëm (13.3%). Megjithatë, është interesante që edhe pse ‘fjalimet joformale në xhami nga imamët e vetëshpallur’ ishte përgjigjja e dytë në terma të përgjithshëm, ajo ishte opsioni më i përzgjedhur në Komunën e Gazi Babës në aspektin e komunave dhe nga maqedonasit në aspektin e përkatësisë etnike të të anketuarve.

“Sipas jush, cila nga të parashtruarat është mënyra më efektive e përdorur nga grupat ekstremiste për përhapjen e propagandës dhe rekrutimit të të rinjve tek grupet e tyre?”

📌 Rezultate nga pyetja “Sipas jush, cila nga të parashtruarat është mënyra më efektive e përdorur nga grupat ekstremiste për përhapjen e propagandës dhe rekrutimit të të rinjve tek grupet e tyre?”




Një gjetje shumë e rëndësishme e këtij sondazhi të opinionit ka të bëjë me qëndrueshmërinë e bashkësisë ndaj këtij fenomeni. Në të vërtetë, të anketuarit u pyetën se si do të reagonin nëse disa anëtarë të familjes ose një mik i tyre tregon interes për t'u bashkuar me ISIS në Siri dhe Irak, 63% prej tyre deklaruan se do të përpiqeshin të flasin me ta në mënyrë që t'i kthenin ata nga vendimi. Lidhur me këtë, 8% deklaruan se do ta raportonin këtë tek zyrtarët. Duke qenë kështu, se të dyja janë mekanizma të ndërmarjes së veprimit kundër rekrutimit, përqindja e përgjithshme e qëndrueshmërisë (elasticitetit) në total është 71%. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të konsiderohet se numri i ultë i atyre që do të raportojnë këtë çështje tek zyrtarët (8%), tregon mungesën e besimit tek institucionet publike. Nga ana tjetër, 21.2% e tyre deklaruan se nuk do të ndërhyjnë dhe 0.6% do të mbështesin vendimin e tyre (7.2% nuk kishin përgjigje). Përsa u përket komunave, 73% e të intervistuarve nga Gazi Baba, 71% nga Çairi dhe 68% nga Saraji deklaruan se do të përpiqeshin të flasin me ta ose të raportojnë tek zyrtarët. Sa i përket përkatësisë etnike, 76% e maqedonasve dhe 78% e shqiptarëve deklaruan se do ta bënin të njëjtën.


Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme

“Nëse ndonjë i afërt i juaj, sikurse ndonjë anëtar i familjes, farefis ose shok/shoqe, shpreh interesim për të luftuar në Siri ose Irak, çfarë do të bënit?”


1 Rezultate nga pyetja “Nëse ndonjë i afërt i juaj, sikurse ndonjë anëtar i familjes, farefis ose shok/shoqe, shpreh interesim për të luftuar në Siri ose Irak, çfarë do të bënit?”



1 Grafika 9.1: Rezultate sipas komunave



1 Grafika 9.2: Rezultate sipas përkatësisë etnike




Në pyetjen nëse ata besojnë se luftëtarët e kthyer të huaj janë një kërcënim potencial i sigurisë ndaj Maqedonisë, pothuajse gjysma e të anketuarve (48.2%) janë përgjigjur ‘Po’, ndërsa 34.1% janë përgjigjur ‘Jo’ (17.7% janë përgjigjur ‘nuk e di’). Është interesante, kur është pyetur nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhet t’i ndihmojë qytetarët e saj të kthehen nga Siria dhe Iraku nëse janë penduar për pjesëmarrje në grupet ekstremiste, 51% e tyre janë përgjigjur pozitivisht për këtë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme tek të intervistuarit nga Saraji (71%) dhe Çairi (64%) sa u përket komunave. Sa i përket përkatësisë etnike, shumica e maqedonasve (44%) deklaruan se nuk duhet të mbështeten që janë kthyer, dhe përgjigja e dytë më e zakonshme ishte 30%. Nga ana tjetër, 71% e shqiptarëve mbështesin kthimin e tyre nëse luftëtarët e huaj janë penduar.

Të pyetur se deri në cilën masë ata do të mbështesin ose do të kundërshtojnë pasojat juridike, duke përfshirë edhe dënimin me burgim, për qytetarët që kthehen nga konfliktet e huaja, 55.6% përkrahin, ndërsa 19.5% kundërshtojnë këto pasoja (25% e mbetur nuk kanë përgjigje). Megjithatë, kur u pyetën nëse do të mbështesin burgimin e qytetarëve që janë penduar që kanë marrë pjesë në konfliktet e huaja dhe kështu janë kthyer në Maqedoni, 41% e tyre iu përgjigjën me “jo” kësaj pyetjeje. (34% u përgjigjën “po” dhe 25% u përgjigjën “nuk e di”). Përsa i përket përkatësisë etnike, shumica e maqedonasve përkrahin burgimin (44%) edhe pse luftëtarët e huaj janë penduar dhe janë kthyer në vend, ndërsa më shumë se gjysma e shqiptarëve (54%) e kundërshtojnë burgosjen në këtë gjendje. Është gjithashtu e konsiderueshme që si grupmosha është më e vjetër, mbështetja për këto burgime rritet.

“A do ta kishit përkrah burgimin e qytetarëve që janë penduar për pjesëmarrje në konflikte të huaja dhe kthehen në Maqedoni?”


1 Grafika 10: Rezultate nga pyetja “A do ta kishit përkrah burgimin e qytetarëve që janë penduar për pjesëmarrje në konflikte të huaja dhe kthehen në Maqedoni?”




Në pyetjen nëse ata janë për ose kundër rehabilitimit dhe reintegrimit në shoqëri të qytetarëve të kthyer, më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) deklaruan se do t'i mbështesin ato programe. Megjithatë, është e konsiderueshme që sa i përket përkatësisë etnike, maqedonasit janë përgjysmuar në përgjigjen e tyre, ndërsa shumica e shqiptarëve (68%) janë për këtë lloj rehabilitimi dhe riintegrimi.

“A do ta kishit përkrah ose kundërshtuar rehabilitimin dhe re-integrimin në shoqëri të qytetarëve të Maqedonisë që kthehen nga konfliktet e huaja?”

1 Grafika 11: Rezultate nga pyetja “A do ta kishit përkrah ose kundërshtuar rehabilitimin dhe re-integrimin në shoqëri të qytetarëve të Maqedonisë që kthehen nga konfliktet e huaja?”



1 Grafika 11.2: Rezultate sipas përkatësisë etnike



Në përgjithësi, rezultatet e sondazhit tregojnë se ekziston një qëndrueshmëri (elasticitet) tashmë ekzistues në këto tri komuna kur është fjala për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, në veçanti kundër ISIS-it. Nga ana tjetër, diferencimi në qëndrimet e prejardhjeve etnike në shumë nga pyetjet rreth ekstremizmit të dhunshëm tregon se çështja e ISIS-it perceptohet si një problem i një bashkësie të caktuar etnike.

Konkluza

Pas fushbetejave në Siri dhe vetëshpalljes së të ashtuquajturit ‘Shtet Islamik’, fenomeni i rekrutimit të grupeve ekstremiste të dhunshme nga Maqedonia ka arritur pikën e kulminacionit. Megjithatë, ky studim hulumtues tregon se pas operacioneve të Qelizës 1 (6 gusht 2015) dhe Qelizës 2 (9 korrik 2016), tendenca për t’u bashkangjitur fushbetejës së Sirisë dhe Irakut ka rënë. Nga ana tjetër, disa nga gjetjet tregojnë se grupet e dhunshme ekstremiste janë bërë më “nëntokësore” në aspektin e funksionalitetit dhe komunikimit të tyre në nivel lokal.

Megjithatë, ky studim hulumtues gjithashtu tregon se perceptimi rreth ‘ekstremizmit të dhunshëm’ në vend ka fituar një dimension të ri pas krizës politike në vitet e fundit. Pas thirrjeve të zyrtarëve të mëparshëm qeveritarë të vendit për t’u bashkuar me protestat e grupeve të së djathtës ekstreme²⁹ dhe sulmi i mëpastajshëm brutal në Kuvendin e Maqedonisë më 27 prill 2017, çështja e ‘ekstremizmit të dhunshëm’ perceptohet si një fenomen me natyrë të ndryshme, që sipas gjetjeve, nuk ka në fund të fundit një fokus në rekrutimin e ISIS dhe Al-Nusra.

Gjetjet kyçe të këtij studimi gjithashtu i referohen një elasticiteti tashmë ekzistues të bashkësisë në terma, por jo të bazuar në një bashkëpunim funksional midis vetë bashkësisë dhe palëve të tjera të interesit, në veçanti institucioneve publike. Arsyja kryesore për këtë është besimi i ulët për shkak të politizimit të mëhershëm të çështjeve gjyqësore dhe politizimit të administratës publike, veçanërisht të shkollave të mesme në nivel lokal. Punësimet e bazuara në përkatësitë politike / nepotizmi dolën nga problemi i punësimit të profileve që, në bazë të gjetjeve të këtij hulumtimi, në disa raste duket të jenë vendimtare për nxitjen e ekstremizmit mes nxënësve të shkollave të mesme. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të merret në konsideratë që çdo aktivitet i ardhshëm në drejtim të parandalimit të këtij fenomeni në nivel lokal duhet të bazohet kryesisht në ndërtimin e besimit midis palëve të interesuara.

Aktivitetet në natyrë janë një tendencë shumë e përmendur në drejtim të nxitësve të procesit të radikalizimit dhe fitimit të pasuesve të rinj të mundshëm për grupet e dhunshme ekstremiste. Mungesa e përfshirjes së shkollave për angazhimin e të rinjve përmes aktiviteteve jashtë-shkollore, kapacitetet e pamjaftueshme dhe interesimi i ulët për OJQ-të lokale u lejojnë grupeve ekstremiste të dhunshme të jenë aktive në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, ndërtimi i kapaciteteve për shkollën e mesme lokale për të organizuar aktivitete të tilla është e pashmangshme për krijimin e mekanizmave parandalues në bashkësi.

Predikuesit fetarë janë gjithashtu aktorë të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të qëndrueshmërisë së bashkësisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Ato mund të jenë profilet kryesorë në vijën e parë të frontit për parandalimin e këtij fenomeni, veçanërisht në nivel lokal. Duke marrë parasysh se mësuesit e shkollave të mesme theksuan rëndësinë e sigurimit të njohurive mbi fetë nga burimet zyrtare duke e strukturuar atë brenda programit mësimor, kjo vë në dukje një dinamikë sociale me fokus në bashkëpunimin mes bashkësive fetare dhe shkollave të mesme.

^{29*} Deklaratë për mediat e Nikola Gruevski, Kryeministër i mëparshëm dhe lider i VMRO-DPMNE, e qasur në: <http://sitet.com.mk/gruevski-jas-veruvam-vo-mojot-narod-i-na-kraj-kje-pobedi-makedonija> (Nikola Gruevski: I besoj popullit tim dhe Maqedonia do të fitojë në fund)

Analiza e sondazhit të opinionit tregon se bashkësia është për një kornizë ligjore për luftëtarët e huaj që janë penduar për përfshirjen e tyre në grupet ekstremiste të dhunshme dhe janë kthyer në atdheun e tyre. Kjo mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit në mes të zyrtarëve shtetërorë dhe bashkësisë. Për më tepër, kjo gjithashtu mund të ndihmojë në ndërtimin e qëndrueshmërisë ekzistuese të bashkësisë me policinë komunale.

Ky studim hulumtues ka ekspozuar gjithashtu rëndësinë e fokusimit në propagandën në internet në gjuhët lokale. Është vërejtur se përmbajtja në internet e cila është e disponueshme në mjetet e mediave sociale si Facebook dhe YouTube luan një rol “katalizues” në procesin e radikalizimit në mesin e të rinjve. Kështu, kundërvënja ndaj radikalizimit në internet përmes raportimit të përmbajtjeve tek mekanizmat përkatës është i pashmangshëm për zyrtarët e sigurisë së vendit. Për më tepër, është gjithashtu e rëndësishme të fokusohen në profilet lokale të rreme që janë aktive për rekrutimet në internet. Prandaj, vendosja e narrativave të kundërta në internet në gjuhët lokale është jetike për ndërtimin e qëndrueshmërisë në internet.

Rekomandime

QEVERIA

- Të sigurohet kornizë ligjore për ish luftëtarët që janë penduar për bashkëngjitjen e tyre me grupet e dhunshme ekstremiste, në lidhje me kushtet specifike, siç është mospasja e të dhënave paraprake kriminale. Një praktikë e mirë në këtë drejtim është Ligji për Pendim efektiv i Turqisë, i cili u zbatua për ish-luftëtarët e PKK-së të organizatës terroriste kurde. Përkatësisht, ish-luftëtari duhet të tregojë vullnetin për të bashkëpunuar me institucionet publike në aktivitetet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm (p.sh. organizimi i takimeve informative me shkollat e mesme në të cilat ish kundërvëniari do të ndajë përvojat e tij/saj personale me nxënësit)

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

- Të organizohen ngjarje informative për ngritjen e vetëdijes për ekstremizmin e dhunshëm dhe rolin e mësuesve në parandalimin e tij.
- Të organizohen aktivitete / ngjarje të përbashkëta me OJQ-të në lidhje me rëndësinë e angazhimit të të rinjve në parandalim / luftim të ekstremizmit të dhunshëm.
- Të përfshijë programin mësimor rreth njohurive bazë mbi fetë dhe rëndësinë e tyre në ndërtimin e paqes dhe kohezionit social në bashkësi.
- Të rriten kapacitetet e shkollave të mesme për të organizuar aktivitete në natyrë me nxënësit të bazuar në preferencat dhe interesat e tyre.
- Të rritet ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e komunikimit të prindërve me profesorët e shkollave të mesme përmes ndryshimit të modelit të mbledhjeve prindërore, në të cilin mësuesi i klasës duhet të vizitojë prindërit në shtëpitë e tyre përkatëse.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

- Të rritet ndërtimi i besimit në bashkësi duke organizuar ngjarje të përbashkëta me shkollat e mesme lokale (p.sh. vizita studimore në MPB) dhe OShC-të në lidhje me rëndësinë e sigurisë publike dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.
- Të ristrukturohet komunikimi me palët e interesuara lokale dhe krijimi i mekanizmave për bashkëpunim të qëndrueshëm me ta. Modeli i policisë komunale mund të jetë një praktikë e mirë në këtë drejtim.
- Përfshirja e “ekstremizmit të dhunshëm” si një temë specifike për raportim brenda mekanizmit të Pullës së kuqe në dispozicion në faqen zyrtare të Ministrisë.

KOMISIONI KOMBËTAR PËR PARANDALIM TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT

- Të zhvillohen kapacitete në kundërvënien e radikalizimit në internet.
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me palët e interesuara si Ministria e arsimit dhe shkencës, Ministria e drejtësisë, Ministria e punës dhe politikës sociale, bashkësitë fetare, OJQ-të etj., në trajtimin e faktorëve kryesorë dhe nxitësve që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm.
- Të propozojë ndryshime ligjore në ligj që kriminalizojnë pjesëmarrjen në luftërat e huaja, neni 322-a që do të lejonte profesionistë të caktuar (punëtorë fetarë, socialë, shëndetësorë ose persona të specializuar që do të ishin përgjegjës për aktivitetet e de-radikalizimit) t'u qasen luftëtarëve të huaj pa qenë të ndjekur penalisht për mos raportimin e tyre tek autoritetet.
- Të monitorojë dhe të vlerësojë zbatimin e planeve të veprimit që janë parashikuar në strategjitë e CT / CVE (luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm)
- Të marrin në konsideratë bashkësitë fetare si një nga aktorët kryesorë në aktivitetet për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm.

BASHKËSITË FETARE

- Të organizohen ngjarje dhe deklarata të përbashkëta për bashkëpunimin për parandalimin e çdo lloj ekstremizmi të dhunshëm dhe gjithashtu të nxiten aktivitetet e dialogut ndërfaqetar nëpërmjet organizimit të konferencave në këtë temë.
- Të krijojnë platforma online në të cilat predikuesit me prejardhje të ndryshme fetare do të japin mesazhe në gjuhët lokale rreth kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe rëndësinë e kohezionit social dhe qëndrueshmërinë e bashkësisë.
- Bashkësia fetare islame (BFI) duhet të jetë më aktive në bashkëveprimin me bashkësinë myslimane përmes karakteristikave të internetit (p.sh. Vendorsja e platformës “Pyetje dhe përgjigje” në internet për informimin e bashkësisë lokale rreth çështjes së ekstremizmit të dhunshëm)

OJQ-TË

- Të janë më aktiv në përfshirjen e projekteve të parandalimit / kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
- Të organizohen aktivitete dhe fushata që do të rrisin ndërgjegjësimin e angazhimin të të rinjve në sigurinë dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.
- Të bashkëpunojë me Komitetin Kombëtar për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit për zbatimin e Planeve të veprimit që kanë të bëjnë me nivelin e bashkësisë.

Bibliografi

DOKUMENTE ZYRTARE

- 2002 Rezultatet nga regjistrimi në Rep. e Maqedonisë, e qasur në: http://www.stat.gov.mk/pdf/kniga_13.pdf
- Faqja zyrtare e internetit e Komunës së Çairit, e qasur në: http://cair.gov.mk/popullsia_cair.html/
- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, e qasur në: <http://unpan1.un.org/intra-doc/groups/public/documents/untc/unpan016120.pdf>

BOTIME

- Komisioni Evropian, “Supporting the Prevention of Radicalization Leading to Violent Extremism” (Mbështetja e parandalimit të radikalizimit i cili çon drejt ekstremizmit të dhunshëm), qershor 2016.
- USAID, Guide to Drivers of Violent Extremism (Udhërrefyes për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm), shkurt 2009
- Kaltrina Selimi dhe Filip Stojkovski, Analytica Think Tank. “Assessment of Macedonia’s efforts in Countering Violent Extremism, view from civil society”(Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm). nëntor 2016.
- Richard Barret, Foreign Fighters in Syria (Luftëtarët e huaj në Siri), Soufan Group, qershor 2014.
- Samet Shabani, “Saving schools from violent extremism: a broader approach to CVE with a focus on educational capacities” (Ruajtja e shkollave nga ekstremizmi i dhunshëm: një qasje e gjerë drejt kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm me theks në kapacitetet edukative), shkurt 2017.

INTERVISTA

- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Zef Lush Marku, e realizuar më 01.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Gjorgi Dimitrov, e realizuar më 10.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme të mjekësisë Marija Kiri Sklodovska, e realizuar më 01.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Zef Lush Marku, e realizuar më 24.04.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Saraj, e realizuar më 03.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Arseni Jovkov, e realizuar më 17.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Arseni Jovkov, e realizuar më 17.03.2017

- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Zef Lush Marku, e realizuar më 10.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Vlado Tasevski, e realizuar më 03.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme të mjekësisë Panche Karagjov, e realizuar më 17.03.2017
- Intervistë me profesor të shkollës së mesme pranë shkollës së mesme Zef Lush Marku, e realizuar më 19.03.2017
- Intervistë me Fisnik Shabani, Kryetar i Forumit rinor islam, e realizuar më 02.03.2017
- Intervistë me përfaqësues të OJQ, e realizuar më 05.04.2017
- Intervistë me Besnik Hamiti, bashkëthemelues i LEGIS, e realizuar më 22.03.2017
- Intervistë me Fahmi Osmani, kryetar i Racio, e realizuar më 03.03.2017
- Intervistë me Ilir Idrizi, Fondacioni Albiz, e realizuar më 18.05.2017
- Intervistë me Shaban Tairi, predikues fetar në Komunën e Sarajit, e realizuar më
- Intervistë me Prof. Dr. Fahrudin Ebibi, Dekan i Fakultetit për studime islame, e realizuar më 17.07.2017
- Intervistë me Dr. Fatmir Zaimi, zyrtar fetar i BFI, e realizuar më 08.05.2017
- Intervistë me Omer Bajrami, e realizuar më 30.08.2017
- Intervistë me Bekir Halimi, e realizuar më 28.07.2017
- Intervistë me Besa Arifi, Prof. inordinare pranë Fakultetit të drejtësisë në UEJL, e realizuar më 12.05.2017
- Intervistë me Lura Pollozhani, Hulumtuese pranë Universitetit të Gratz-it, e realizuar më 21.03.2017
- Intervistë me Ali Pajaziti, profesor i Sociologjisë pranë Universitetit të UEJL, e realizuar më 10.04.2017

Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme



Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme

Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme



Të punuarit drejt bashkësive të qëndrueshme

Autorë:

Samet Shabani

Amir Kadri

Shkup 2018



www.analyticamk.org